

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

2018

**RAPORTI
VJETOR**

www.idp.al

RAPORTI VJETOR

2018

1. MESAZHI I TITULLARIT	5
2. REFERENCAT LIGJORE KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT.....	7
3. E DREJTA E INFORMIMIT	9
3.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	9
3.2 Trajtimi i ankesave	12
3.3 Hetime administrative.....	15
3.4 Strategjitë dhe indikatorët.....	16
3.4.1 Strategjia Ndërsektorale për Reformën në Administratën Publike	16
3.4.2 Strategjia Ndërsektorale Antikorrupsion.....	18
4. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	20
4.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”	20
4.2 Trajtimi i ankesave	20
4.3 Hetimet administrative	21
4.4 Rekomandime dhe Urdhra.....	23
4.5 Sanksione administrative	24
4.6 Njoftimi	24
4.7 Transferimi ndërkombëtar	25
5. TRAJTIMI I ANKESAVE SIPAS LIGJIT NR. 146/2014 “PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK”	26
6. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE	27
6.1 Hartimi i akteve rregullatore.....	27
6.2 Dhënie mendimi për projekt/akte	27
6.3 Monitorimi i Fletoreve Zyrtare	28
6.4 Proceset gjyqësore	28
7. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE	30
7.1 Marrëveshje Bashkëpunimi	30
7.2 Bashkëpunim me OSBE.....	30
7.3 Bashkëpunimi me Projektin Star 2 të UNDP	30
7.4 Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile	30
7.5 Bashkëpunimi me ASPA	31
7.6 Trajnime	31
7.7 Të rinjtë	32
7.8 Takime të tjera.....	33
7.9 Evente të rëndësishme	33
8. VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE DHE ORGANIZIMI I KONFERENCËS EVROPIANE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE	35
8.1 Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Tiranë 2018....	35
8.2 Shqipëria Organizatore e Konferencës së 41-të Botërore të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC)	35

8.3 Zyra e Komisionerit bashkëpunon me Instrumentin e Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX).....	36
8.4 Bashkëpunimi me T-PD, EDPB dhe Grupin e Berlinit	36
8.5 Digital Clearinghouse	36
8.6 Marrëdhënia me Eurojust	37
9. MENAXHIMI BUXHETOR	38
9.1 Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale	38
9.2 Struktura Organizative.....	38
9.3 Të ardhurat dhe shpenzimet.....	39
10. PROGRES RAPORTI I BE PËR SHQIPËRINË MBI ZYRËN E KOMISIONERIT	42
11. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE	45
12. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT 2017	46
13. NEVOJA PËR NDRYSHIME NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT	51
13.1 Përafrimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren 2016/679 dhe Direktivën 2016/680 e BE	51
13.2 Miratimi i ndryshimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”	52
13.3 Ndryshime në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin e konsultimit publik”	52
13.4 Miratimi i projekt/ligjit “Mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe përafrimi me direktivën 2013/37/EU.....	53
13.5 Modernizimi i Konventës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale e Këshillit të Evropës (Konventës 108+)	53
13.6 Aderimi në Konventën 2009/205 të Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”	54
14. VIZIONI I INSTITUCIONIT.....	55
ANEKS 1	57
ANEKSI 2.....	60

1. MESAZHI I TITULLARIT

Viti 2018-të ka qenë një vit dinamik, me përgjegjësi dhe sfida të reja, por edhe një vit i konsolidimit të aktivitetit të Zyrës së Komisionerit. Puna jonë gjatë këtij viti u konkretizua në rezultate të prekshme në të dy fushat e veprimtarisë sonë. Zyra e Komisionerit nuk do të kishte qenë e suksesshme në trajtimin e sfidave me të cilat jemi ballafaquar në 2018 pa aftësinë dhe përkushtimin e gjithë stafit.

Në kuadër të së drejtës për informim, Zyra e Komisionerit konstaton progres, në rritjen e përgjegjësisë së Autoriteteve Publike për detyrimet e tyre mbi transparencën dhe dhënien e informacionit publik. Në mbështetje të transparencës me qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion publik, kemi vijuar punën për përmirësimin e procedurave për shqyrtimin e ankesave, por nga ana tjetër dhe nxitjen e autoriteteve publike për të vënë në dispozicion të publikut sa më shumë informacione pa kërkesë.

Qytetarët gjithashtu kanë vijuar të tregojnë besim në zbatimin e të drejtës së tyre për informim, duke u adresuar me ankesa të shumta pranë Zyrës së Komisionerit, për rastet ku pretendojnë se iu është mohuar kjo e drejtë dhe pjesa më e madhe e këtyre ankesave janë përmbushur menjëherë pas ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit.

Në kuadër të të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit është angazhuar në monitorimin e përpunimit të të dhënave personale dhe mbikëqyrjen e respektimit të masave të sigurisë gjatë përpunimit të tyre, nga kontrollues publik dhe privat.

Si rrjedhojë, Zyra e Komisionerit ka pasur një rritje të vazhdueshme të numrit të ankesave. Kompleksiteti i ankesave të mbërritura në adresë të Zyrës së Komisionerit dhe hetimet e shumta administrative, të ushtruara në fusha të ndryshme, si ato publike ashtu dhe private, në sektorë si arsimi, shëndetësia, sektori bankar, organet e vetëqeverisjes vendore etj, janë dëshmi e zhvillimit pozitiv, që e drejta për mbrojtjen e të dhënave personale po merr dita ditës edhe në Shqipëri.

Gjatë këtij viti janë ndërmarrë fushata të vazhdueshme sensibilizuese me publikun, si për kontrolluesit publik ashtu edhe ata privat.

Përpyekjet e vendit drejt anëtarësimit në BE janë intensifikuar ndjeshëm, në funksion të rekomandimit për çeljen e negociatave për anëtarësim.

Zyra e Komisionerit gjatë këtij viti organizoi edicionin e 28-të, të Konferencës së Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, aktiviteti më i rëndësishëm evropian në këtë fushë, i cili u zhvillua për herë të parë në Shqipëri. Në këtë Konferencë, morën pjesë rreth 100 përfaqësues të 62 Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave. Organizimi i kësaj Konference në Shqipëri, është shprehje e vlerësimit të aktivitetit të

Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në arenën ndërkombëtare si dhe nxitje e ndërtimit dhe e forcimit të rrugëve të bashkëpunimit, në mbrojtje të privatësisë së individit.

Me gjithë rritjen e ndjeshmërisë së qytetarëve për të drejtën e tyre për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale si dhe angazhimin e Zyrës së Komisionerit për të zbatuar me korrektësi legjislacionin në fuqi dhe standardet evropiane, mbetet ende sfiduese vendosja e balancës midis të drejtës për informim dhe mbrojtjes së privatësisë, në veçanti në rastet kur këto dy të drejta duhen balancuar dhe me lirinë e shprehjes.

Zyra e Komisionerit është angazhuar gjithashtu në trajtimin e ankesave të ardhura mbi zbatimin e ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Megjithatë mbetet ende punë për t’u bërë, sidomos për sa u përket organeve publike për përgjegjëshmërinë e tyre dhe realizimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik mbi projektligjet, projekt dokumentat strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave me interes të lartë publik.

Të dhënat në këtë raport tregojnë se Zyra e Komisionerit është rregullatori proaktiv për realizimin e objektivave në fushën e të drejtës së informimit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në këtë mënyrë, Zyra e Komisionerit do të përfshihet në një proces dinamik dhe reformues për të plotësuar kushtet për të përmirësuar legjislacionin e të drejtës për informim si dhe transpozimin e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) në legjislacionin kombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale.

2. REFERENCAT LIGJORE KU MBËSHTETET VEPRIMTARIA E INSTITUCIONIT

Hartimi i këtij raporti bazohet në analizën e performancës institucionale për vitin 2018 të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), lidhur me monitorimin dhe zbatimin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Të drejtat e parashikuara në ligjet e sipërcituara, janë pjesë e aktit më të lartë të vendit tonë, Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, konkretisht në nenet 23 dhe 35 të saj.

Veprimtaria e Zyrës së Komisionerit mbështetet në zbatimin me korrektësi të legjislacionit shqiptar, të rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2017”, miratuar në Kuvend më datë 05.04.2018 si dhe detyrimeve që burojnë nga bashkëpunimi ndërkombëtar.

Kompetencat e Zyrës së Komisionerit lidhur me të drejtën e informimit, renditen si më poshtë:

- ✓ Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- ✓ Ankimi administrativ pranë Komisionerit bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur: (i) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit; (ii) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.(10 ditë pune).
- ✓ Me marrjen e ankesës, Komisioneri verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.
- ✓ Komisioneri merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.

Ndërsa, kompetencat e Zyrës së Komisionerit lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale janë:

- ✓ Trajton ankesat e subjekteve të adresuara pranë Zyrës së Komisionerit;
- ✓ Kryen hetime administrative në kontrollues publik e privat (me iniciativë ose mbi bazë ankese), mbi përpunimin e të dhënave personale në përputhje me ligjin nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Kodin e Procedurave Administrative;

- ✓ Ndjek dhe zhvillon seanca dëgjimore me kontrolluesit si dhe propozon në çdo përfundim shqyrtimi, marrjen e masave në përputhje me kompetencat e Komisionerit (rekomandim, vendim, urdhër);
- ✓ Verifikon zbatimin e rekomandimeve;
- ✓ Regjistron Kontrolluesit (formulari i njoftimit) në “Regjistrin elektronik të kontrolluesve” – i aksesueshëm pjesërisht për publikun në faqen online të IDP;
- ✓ Trajton kërkesat për transferime ndërkombëtare të të dhënave;
- ✓ Jep mendime dhe opinione ligjore lidhur me mënyrën e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.
- ✓ Trajnon kontrollues publik dhe privat dhe grupet e interesit (organizata) që mbrojnë të drejtat e subjekteve të të dhënave.

Zyrës së Komisionerit i burojnë kompetenca edhe nga ligje të tjera si:

- Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”;
- Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”;
- Ligji nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”;
- Ligji nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

3. E DREJTA E INFORMIMIT

3.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit ka vijuar punën lidhur me zbatimin dhe monitorimin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Mbikëqyrja e zbatimit të këtij ligji, kryhet nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të tij si p.sh. numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatorë të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna.

Gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit ka monitoruar faqet zyrtare të autoriteteve publike, ka kryer inspektime në terren dhe ka kërkuar informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga ligji nr.119/2014 :

- ✓ publikimi i programeve të transparencës;
- ✓ caktimi i koordinatorit për të drejtën e informimit;
- ✓ publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.

Nga monitorimi i autoriteteve publike ka rezultuar se:



219 Autoritete Publike kanë bërë publik **Programin e Transparencës**



331 Autoritete Publike kanë caktuar **Koordinator për të drejtën e informimit**



178 Autoritete Publike kanë publikuar **Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve**

Nga monitorimi i autoriteteve publike për vitin 2018, ka rezultuar se institucionet të cilat kanë një program të plotë dhe të përditësuar transparence janë **institucionet e pavarura**. Gjithashtu, institucionet e pavarura, kanë të njëjtët koordinator që kanë caktuar që me hyrjen në fuqi të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”. Numri i kërkesave për informim të trajtuara nga këto institucione, gjatë vitit 2018 është **425**, ndërsa numri i kërkesave të refuzuara **6**.

Në lidhje me pushtetin vendor, Zyra e Komisionerit vlerëson se niveli i transparencës së **bashkive** shënon përmirësime. Tashmë të gjitha bashkitë kanë caktuar koordinatorët e të drejtës për informim dhe numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nga bashkitë gjatë vitit 2018 është **7244**, ndërsa numri i kërkesave të refuzuara është **367**.

Disa nga konstatimet që janë vënë re gjatë trajtimit të ankesave në institucionet e pushtetit vendor janë:

- ✓ Vihet re një përmirësim optimal, përsa i përket problematikave të hasura në institucionet e **pushtetit vendor**, me ndërtimin e faqeve të internetit çka sjell lehtësi në aksesimin e informacionit;

- ✓ Pjesa më e madhe e bashkive kanë publikuar programin e transparencës, por informacioni nuk është i përditësuar apo i linkuar, sikurse parashikohet në ligj. Konkretisht një nga informacionet që vijon të mos publikohet është ai që lidhet me buxhetin, prokurimet dhe raportet e auditimit;
- ✓ Disa bashki kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, por problematik mbetet përditësimi i tij.

Zyra e Komisionerit me anë të Urdhrit nr.211, datë 20.09.2018, ka miratuar Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Programi model është hartuar në përputhje me nenin 7, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dispozitat e ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe të ligjit nr.8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e kartës evropiane të autonomisë vendore”.

Për ta bërë më të thjeshtë, të kuptueshëm, të aksesueshëm dhe të përdorshëm programin e transparencës, 16 kategoritë e informacionit të parashikuar shprehimisht në nenin 7, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” si pjesë e tij, janë përshtatur me veçoritë e veprimtarisë të vetëqeverisjes vendore dhe me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkive.

Tabela përmbledhëse e Programit është ndarë në 7 fusha kryesore, në të cilat përfshihen:

Fusha e parë: “Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë”, përfshin kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë të përcaktuar në gërmat a), ç), d), dh), dhe g) të nenit 7, të ligjit 119/2014. Kjo fushë iu ofron qytetarëve informacion për ndarjen administrativo-territoriale, për misionin dhe funksionet e bashkisë, për administratën e bashkisë, për mekanizmat monitorues dhe të kontrollit si dhe për të drejtën e kërkesës, ankesave që lidhen me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës së bashkisë.

Fusha e dytë: “Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare”, përfshin kategoritë e informacionit të përcaktuar në gërmat dh), e), dhe ë), të nenit 7, të ligjit. Këto kategori informacioni janë përshtatur me kërkesat e ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”. Në këtë fushë përfshihen informacione, që kanë të bëjnë me planin strategjik të zhvillimit të bashkisë, me programin buxhetor afatmesëm vendor, mbikëqyrjen dhe auditimin e buxhetit, etj.

Fusha e tretë: “Për kërkesat për informim”, përfshin vendosjen në dispozicion të qytetarëve informacionin që ka të bëjë me procesin, procedurat, format dhe afatet e kërkesës për informim. Përmbledhja e katër kategorive të informacionit të përcaktuar në gërmat c), ç), i) dhe k), të nenit 7, të ligjit, në një fushë të vetme, lehtëson aksesin e qytetarëve për këto kategori informacioni, duke i orientuar dhe udhëzuar ata se si mund të bëjnë një kërkesë për informim.

Fusha e katërt: “Mbi shërbimet që ofron bashkia”, përfshin informacionin e përcaktuar në gërmat f), j), ë) dhe pjesërisht pika a), e nenit 7 të ligjit. Nëpërmjet kësaj fushe vihet

në dispozicion të qytetarëve informacioni për shërbimet publike që ofron bashkia, llojet e shërbimeve, instrumentet e administrimit, kontratat publike, strukturat përgjegjëse, procedurat e ankimit në lidhje me kontratat publike, standardet, treguesit, procedurat për të përfutur shërbime si dhe procedurat e ankesës dhe vërejtjes në lidhje me shërbimet.

Fusha e pestë: “Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore” është informacion i përcaktuar në gërmën b), të nenit 7, të ligjit. Kjo fushë u ofron qytetarëve informacion për legjislacionin, politikën, vendimet, urdhëresat dhe urdhrat me karakter normativ të organeve të bashkisë.

Fusha e gjashtë: “Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje”, përfshin informacion në lidhje me procesin, procedurat, kuadrin rregullator vendor, listën e akteve vendore që i nënshtrohen konsultimit publik dhe nismat qytetare.

Fusha e shtatë: “Informacion tjetër”, bashkia vë në dispozicion të qytetarëve informacione të ndryshme, të tilla si proceset e integritetit evropian (programet dhe projektet); shoqëria civile; raporte, studime të ndryshme, veçanërisht ato në lidhje me vlerësimin e transparencës, vet-organizimi komunitar etj.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, niveli i transparencës për **institucionet e pushtetit qendror** shënon përmirësime në krahasim me vitin 2017, ku për shkak të ndryshimeve në fushat e kompetencave të secilës ministri, pati një përkeqësim të dukshëm lidhur me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji “Për të drejtën e informimit”.

Në kuadër të programeve të dedikuara të transparencës, gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit është angazhuar në ndërgjegjësimin e institucioneve që kanë për objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e mjedisit dhe më konkretisht Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit. Qëllimi i përditësimit ishte pasqyrimi në programet e tyre të transparencës të informacionit mjedisor në përputhje me kërkesat e Konventës së Aarhusit, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit”, legjislacionit vendas si dhe akteve nënligjore në fushën e mjedisit. Në mënyrë specifike, përfshirjen e informacionit që ka të bëjë me njohjen e publikut me procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis, sipas V.K.M nr.247/2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave dhe procedurave për informim dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.

Megjithatë nga monitorimi, vijnë të konstatohen problematika lidhur me nivelin e transparencës së **ministrive** si më poshtë:

- ✓ Programet e transparencës nuk janë të përditësuara dhe mungon një pjesë e dokumenteve të cilat duhet të jenë të publikuara, në kuptim të nenit 7, të ligjit “Për të drejtën e informimit”. Një nga informacionet që vijon të mos publikohet është ai që lidhet me buxhetin, prokurimet dhe raportet e auditimit;

- ✓ Konstatohet se koordinatorët për të drejtën e informimit, janë në nivel specialisti dhe kanë akses të limituar në strukturat e tjera të ministrisë. Kjo sjell vështirësi në vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar brenda afatit 10 ditor;
- ✓ Gjithashtu, janë konstatuar raste kur kërkesat për informacion nuk kalojnë tek koordinatori, por delegohen në struktura të tjera të ministrisë, duke u trajtuar njësoj si shkresat e tjera, që lidhen me aktivitetin e përditshëm të autoritetit publik;
- ✓ Koordinatorët e të drejtës për informim nuk zotërojnë njohuritë e mjaftueshme për kuadrin ligjor, çka sjell që zbatimi i këtij ligji të mos jetë në nivelin e duhur. Ky fakt bëhet pengesë dhe për rolin që ato duhet të luajnë lidhur me koordinimin e mbledhjes së informacionit.

Gjatë vitit 2018, koordinatorët për të drejtën e informimit të ministrive kanë trajtuar gjithsej **728 kërkesa për informacion publik** ndër të cilat vetëm **9 prej tyre janë refuzuar**.


Gjithashtu, zbatimi i standardeve më të mira ndërkombëtare kërkon që koordinatorët të jenë të trajnuar dhe të kualifikuar, madje të jenë dhe të stimuluar financiarisht.

Për sa më sipër, vijon puna për të ofruar trajnime për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe për të rritur ndërgjegjësimin e autoriteteve publike për t’iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve sipas parashikimeve ligjore.

3.2 Trajtimi i ankesave

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” gjatë vitit **2018**, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan **820 ankesa**, prej të cilave **622** janë zgjidhur me ndërmjetësim. Për **37** nga këto ankesa, Komisioneri është shprehur me vendim, **116** ankesa kanë rezultuar jashtë objektivit, **9** ankesa kanë qenë jashtë afatit, **17** ankesa kanë rezultuar të paplota dhe **24** ankesa vijojnë në proces.

Për vitin 2018, nga 820 ankesa :



Fakti që pjesa më e madhe e ankesave janë zgjidhur me ndërmjetësim tregon efektivitetin e ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit. Pjesa më e madhe e ankesave të shqyrtuara nga Zyra e Komisionerit kanë qenë ankesa të drejtuara nga qytetarët. Konkretisht 656 ankesa janë depozituar nga qytetarët, ndërsa 164 ankesa janë depozituar nga organizatat e shoqërisë civile. Fakti që numri më i madh i ankesave vijnë nga qytetarët është një tregues mjaft i mirë i impaktit të ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit i kushton rëndësi edhe marrëdhënieve me shoqërinë civile dhe kjo pasqyrohet në bashkëpunimin e mirë që ka krijuar me organizatat e shoqërisë civile si dhe me rrjetin e gazetarëve, veçanërisht atë të gazetarisë investigative. Në këtë kontekst, disa nga organizatat e shoqërisë civile të cilat kanë si pjesë të veprimtarisë së tyre mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, edhe këtë vit e kanë vlerësuar Zyrën e Komisionerit si institucionin më transparent në nivel kombëtar.

Fushat ku është përqendruar vendimmarrja e Komisionerit gjatë vitit 2018 ka përfshirë informacionin publik në kuadër të arbitrazhit ndërkombëtar ku palë ka qenë shteti shqiptar, fushën e prokurimeve, atë energjetike ku fokusi ka qenë mbi koncesionet dhe dokumentet e lidhura me to, gjyqësorin, informacionin lidhur me procesin e reformës në drejtësi, fushën e statistikave, kujdesin shëndetësor, transparencën lidhur me organikën e autoriteteve publike, sektorin e tatimeve, etj.

Nga procesi i trajtimit të ankesave dhe hetimeve administrative është evidentuar shpesh një qasje refuzuese e autoriteteve publike kundrejt parimeve të transparencës dhe llogaridhënies ndaj qytetarëve, e cila është materializuar me anë të referimit në parimin e konfidencialitetit apo në dispozita ligjore të ndryshme me qëllim shmangien e bërjes publik të informacionit të kërkuar.

Pavarësisht këshillimit nga ana e Zyrës së Komisionerit nëpërmjet arsytimeve të detajuara (në vendime, kërkesa për parashtrime apo gjatë seancave dëgjimore) lidhur me pabazueshmërinë e argumenteve të ofruara për refuzimin e dhënies së informacionit, në shumë raste qëndrimi i autoriteteve publike të evidentuara si problematike ka vijuar të mbetet i njëjtë.

Konkretisht është evidentuar se disa autoritete publike, dhe në mënyrë specifike ato të angazhuara në fushën e zhvillimit të territorit apo trashëgimisë kulturore i referohen vazhdimisht legjislacionit për të drejtën e autorit, si arsye për mosvënien në dispozicion të dokumentacionit lidhur me lejet e ndërtimit apo zhvillimit, i cili në kuptim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” përbën informacion publik. Pavarësisht arsytimit ligjor të dhënë nga ana e Zyrës së Komisionerit mbi pabazueshmërinë e këtij qëndrimi, referuar edhe ligjit nr.35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, qasja e autoriteteve publike në më të shumtën e rasteve ka vijuar të mbetet e njëjtë.

Po ashtu, problematik ka rezultuar dhe sektori energjetik, përse i përket informacionit publik lidhur me kontratat koncesionare. Autoritetet publike të angazhuara në këtë sektor në mënyrë të përsëritur referojnë në parimin e konfidencialitetit, si arsye për mosvënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, objekt i të cilit kanë qenë sipas rastit kopjet e kontratave koncesionare, oponencat teknike, studimet e fizibilitetit, lejet mjedisore apo dokumente të tjera që kanë bërë me këto kontrata. Komisioneri ka marrë një numër të konsiderueshëm vendimesh, ku qëndrimin e tij e ka shoqëruar me argumentin ligjor mbi publikimin e kësaj kategorie informacioni, qoftë në bazë të parimeve të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, qoftë në bazë të legjislacionit specifik në fushën e koncesioneve dhe partneriteteve publike private, megjithatë ky sektor vijon të mbetet problematik.


E njëjta problematikë është evidentuar edhe në fushat e tjera, që kanë qenë objekt i vendimarrjes së Komisionerit gjatë vitit 2018, ku si arsye kryesore për mosbërjen e transparencës është referuar parimi i konfidencialitetit dhe kufizimet e nenit 17, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Vlejnë të përmenden në këtë kuadër, vendimet e Komisionerit në fushën e arbitrazhit ndërkombëtar me palë shtetin shqiptar si dhe ato në fushën e statistikave. Pranë Zyrës së Komisionerit janë depozituar ankesa mbi refuzimin e dhënies së informacionit lidhur me proceset e arbitrazhit ndërkombëtar me palë shtetin shqiptar. Pavarësisht se informacioni i kërkuar ka qenë përgjithësisht elementar (si p.sh lista e shoqërive që aktualisht janë në proces arbitrazhi me shtetin shqiptar) qasja e autoritetit publik kompetent ka qenë negative, duke referuar në parimin e konfidencialitetit. Vendimet e Komisionerit për këto raste janë lënë në fuqi dhe nga gjykata administrative e shkallës së parë. I njëjtë ka qenë qëndrimi i gjykatës edhe në lidhje me vendimet e Komisionerit në fushën e informacionit statistikor.

Gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit ka marrë një sërë vendimesh mbi ankime të depozituara nga organizatat e shoqërisë civile në lidhje me qëndrimin e autoriteteve publike të përfshira në procesin e reformës në drejtësi kundrejt kërkesave për informacion publik. Në vendimet e tij, Komisioneri e ka vlerësuar me shumë rëndësi transparencën në këtë proces, duke e konsideruar si një element shtesë në përmbushjen e pritshmërive të publikut nga kjo reformë. Hartimi i tyre ka kërkuar angazhim të veçantë nisur nga kompleksiteti i paraqitur dhe ato kanë shënuar një hap cilësor në vendimarrjen e Komisionerit, duke shërbyer edhe si një udhërrëfyes për shumë raste të ngjashme apo autoritete të tjera publike me një rol në procesin e reformës në drejtësi, sa i përket qasjes së tyre kundrejt kërkesave për transparencë.

Duhet përmendur se edhe në ato raste që janë ankimuar në gjykatë, kjo e fundit i ka lënë përgjithësisht në fuqi vendimet e Komisionerit, duke e quajtur si të drejtë dhe të bazuar arsyetimin e tij në vendimarrjen e cituar më sipër.

Ankesa në vite 2014-2018




Nga grafiku i mësipërm duket që ka një rritje të numrit të ankesave nga viti 2017 në vitin 2018 dhe për më tepër fakti që pjesa më e madhe e ankesave janë bërë nga qytetarët, ndryshe nga vitet e kaluara ku dominonin ankesat nga shoqëria civile, tregon se është rritur dukshëm ndërgjegjësimi lidhur me efektivitetin e ligjit për të drejtën e informimit si dhe besimi ndaj Zyrës së Komisionerit, si mekanizëm për garantimin e kësaj të drejte.

3.3 Hetime administrative

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit, ka vijuar punën për realizimin e përgjegjësisë kryesore, mbikëqyrjen dhe garantimin e të drejtës së qytetarëve për akses në informacion publik, duke u mbështetur në vendosjen e balancës dhe respektimin e parimit të proporcionalitetit.

Zyra e Komisionerit ka realizuar **93** hetime administrative në fushën e të drejtës për informim me synim verifikimin e ankesave të depozituara. Janë dërguar pranë autoriteteve publike **195** kërkesa për parashtrime, ndërsa **24 ankesa** vijnë në proces. Gjithashtu, janë dhënë **37** vendime për autoritetet publike, prej të cilave **30** vendime urdhërimi, **3** vendime rrëzimi, si dhe **4** vendime me sanksion gjobë. Gjatë këtij viti janë realizuar **29** seanca dëgjimore.

INSPEKTIME NË VITE 2014-2018



3.4 Strategjitë dhe indikatorët

Me anë të V.K.M nr.145, datë 13.03.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit” u miratua krijimi i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve.

Ky regjistër u instalua në 27 institucione qendrore si: Kryeministria, Ministria Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Banka e Shqipërisë, Kontrolli i Lartë i Shtetit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Agjencia e Prokurimit Publik, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, Policia e Shtetit, Qendra Kombëtare e Biznesit dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore si: Bashkia Durrës, Elbasan, Fier, Korçë, Lezhë, Tiranë dhe Shkodër.

Gjithashtu, u zhvilluan trajnime për koordinatorët dhe stafin IT të këtyre institucioneve të cilët u pajisën dhe me një manual lidhur me përdorimin e sistemit. Numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet sistemit është **237** në periudhën mars – dhjetor 2018, ndërsa në po të njëjtën periudhë numri i ankesave drejtuar Zyrës së Komisionerit është **50** në total.

3.4.1 Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike

Zyra e Komisionerit, si një institucion i cili ka në fokus forcimin e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve publike, është pjesë e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015–2020 (SNRAP). Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë aktive dhe ka dhënë kontributin e saj në takimet e organizuara.

Plani i veprimit të SNRAP

Nga raportet e monitorimit vjetor për zbatimin e Planit të Veprimit të SNRAP, rezultojnë që aktivitetet për të cilat është përgjegjëse Zyra e Komisionerit janë përmbushur në përputhje me pasaportën e indikatorëve të kësaj strategjie.

Zyra e Komisionerit ka realizuar pjesërisht masat e parashikuara në plan veprimi. Për shkak të ristrukturimit të institucioneve të pushtetit qendror, jo të gjitha institucionet qendrore kanë një program të përditësuar transparence. Ndërsa lidhur me përdorimin e faqeve të internetit për publikimin e informacioneve dhe akteve të institucioneve, kjo është një masë e realizuar pjesërisht sepse është një aktivitet i cili do të vijojë dhe në planin e ri të veprimit.

Në bashkëpunim me përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike si dhe me asistencën e ekspertëve të SIGMA/OECD, Zyra e Komisionerit ka hartuar masat që do të ketë në Planin e Veprimit të SNRAP për vitet 2018-2020.

Objektivi që duhet të përmbushë Zyra e Komisionerit në këtë strategji është : Forcimi i kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike për garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesin në informacion.

Ky objektivi synohet të arrihet nëpërmjet aktiviteteve dhe nën aktiviteteve si:

1. Vënia në zbatim e programit institucional të transparencës nga autoritetet publike;
 - a) Plotësimi me programet e transparencës për të gjitha institucionet e administratës qendrore;
 - b) Hartimi i programeve model të transparencës për pushtetin vendor;
 - c) Të gjitha bashkitë miratojnë dhe zbatojnë programet e transparencës.
2. Përdorimi i mjeteve TIK për të rritur transparencën e veprimtarisë së administratës:
 - a) Vënia në funksion të plotë i regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve;
 - b) Trajnimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit lidhur me përdorimin e regjistrit qendror të kërkesave dhe përgjigjeve;
 - c) Vlerësim të plotë ex-post të ligjit për të drejtën e informimit.
3. Ngritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore të KDIMDP për monitorimin e ligjit për të drejtën e informimit:
 - a) Rishikimi i strukturës së KDIMDP me synimin forcimin e kapaciteteve monitoruese për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit;
 - b) Trajnime për forcim kapacitetesh në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Indikatori

Për vitin 2018 indikatori (nr.11.a) i cili mat numrin e ankesave të paraqitura çdo vit pranë Komisionerit, ka pasur tendencë në rritje. Sikurse është parashikuar dhe në pasaportën e indikatorit nga 560 ankesa të shqyrtuara në vitin 2017, në vitin 2018 janë shqyrtuar 820 ankesa. Lidhur me numrin e sanksioneve të aplikuara nga ana e Komisionerit ndaj institucioneve, të cilat pas inspektimeve të kryera në bazë të raportimit, kanë rezultuar që nuk kanë dhënë informacion është 0.04 ndërsa në vitin 2017 kjo shifër ka qenë 0.06.

Në bashkëpunim me ekspertët gjermanë të projektit SIGMA/OECD, është hartuar një manual trajnimi për mësuesit dhe nxënësit e gjimnazeve lidhur me të drejtën e informimit. Janë hartuar dy manuale që kanë të bëjnë me kufizimet e nenit 17, të ligjit “Për të drejtën e informimit” si dhe është hartuar një material i cili analizon të gjitha Direktivat e BE lidhur me informacionin mjedisor, informacionin gjeohapësinor apo ripërdorimin e informacionit publik.

Zyra e Komisionerit ka kërkuar nga 128 Autoritete Publike informacion mbi regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve si dhe vetëdeklarim mbi përmbushjen e detyrimeve ligjore që dalin në përputhje me nenin 15, të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Nga përgjigjet e tyre rezulton se për vitin 2018 janë trajtuar 10946 kërkesa për informacion dhe vetëm 401 prej tyre janë refuzuar, që përbën vetëm 3.7%. Në këtë mënyrë indikatori është realizuar në masën 96.3%.

3.4.2 Strategjia Ndërsektorale Antikorrupsion

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është pjesë e Strategjisë Ndër-sektorale kundër Korrupsionit 2015-2020. Qëllimi i Strategjisë është të vendosë objektivat strategjike dhe drejtimin kryesor politik, që do të udhëheqë planin e veprimit të Qeverisë në luftën ndaj korrupsionit gjatë viteve të ardhshme.

Shqipëria bën pjesë në iniciativën Rajonale të Anti-Korrupsionit, platformë e cila shërben për shkëmbimin e ekspertizës dhe njohurive në këtë fushë dhe për koordinimin e përpjekjeve ndërmjet degëve shtetërore. Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit ka marrë pjesë në një vizitë studimore të organizuar nga ky Projekt Binjakëzimi, i cili u organizua në Vjenë të Austrisë. Gjatë kësaj vizite studimore, pjesëmarrësit u trajnuan në disa nga institucionet më të rëndësishme austriake të luftës kundër korrupsionit.

Projekti i Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-Bashkimi Evropian ka asistuar Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale me dy trajnime specifike mbi “Transparenca në Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE-së (GDPR)” dhe Direktiva 2016/680 e BE-së.

Zyra e Komisionerit dhe Ministria e Drejtësisë organizuan Forumin e 3-të Konsultativ Anti-korrupsion me temë “*E drejta për informim*”. Të pranishëm në këtë takim ishin përfaqësues të autoriteteve publike, botës akademike, shoqërisë civile dhe medias. Forumi është pjesë e agjendës së “*Projektit të Binjakëzimit Anti-korrupsion Shqipëri-BE*”.

Në vazhdim të “Projektit të binjakëzimit anti-korrupsion Shqipëri-BE”, Zyra e Komisionerit mori pjesë në Festivalin shqiptar të filmit anti-korrupsion, me temë “Në lëvizje—In motion”. Aktiviteti u organizua në formën e një guide ndërgjegjësuere. Festivali ka për qëllim krijimin e hapësirës për trajtimin e ideve dhe iniciativave për të luftuar këtë fenomen.

Janë realizuar 3 trajnime me përfaqësues të autoriteteve publike vendore në bashkitë Korçë, Shkodër dhe Kukës në lidhje me vendosjen e një balance midis të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale në rastet e paraqitjes së kërkesave për informacion publik. Në total janë trajnuar 81 përfaqësues të autoriteteve publike.

Në kuadër të “Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-BE”, me koordinimin e Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale janë zhvilluar:

- ✓ 3 trajnime me temë: “Mbi të drejtën e informimit dhe aksesin në informacion publik” me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, si dhe institucionet e varësisë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe Autoriteti i Konkurrencës, duke përfshirë stafin e Zyrës së Komisionerit. Në total janë trajnuar 66 përfaqësues të autoriteteve publike;
- ✓ 3 trajnime me koordinatorët e të drejtës për informim të ministrive dhe përfaqësues të strukturave të auditimit të brendshëm dhe njësive të prokurimit publik në këto institucione dhe ato të varësisë. Trajnimet u përqëndruan tek procesi i dhënies së informacionit publik në përputhje me veprimtarinë specifike institucionale dhe mekanizmat ligjorë në fuqi;
- ✓ 3 trajnime të stafit të Zyrës së Komisionerit nga ekspertë të huaj mbi eksperiencën evropiane në fushën e të drejtës për informim dhe transparencës publike.

Janë trajnuar 27 koordinatorët për të drejtën e informimit mbi përdorimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve. Në “Ditën Ndërkombëtare të të Drejtës për Informim” u mbajt në mjediset e Kryesisë së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë aktiviteti ndërgjegjësues me pjesëmarrjen e 61 nxënësve dhe mësuesve të shkollave të mesme të kryeqytetit. Gjithashtu janë realizuar 2 video ndërgjegjëse mbi të drejtën e informimit dhe përdorimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe është publikuar një fletëpalosje ndërgjegjëse mbi përdorimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe përgjigjeve.

4. MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

4.1 Monitorimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”

Në kuadër të monitorimit dhe mbikëqyrjes së ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, Zyra e Komisionerit gjatë këtij viti ka ndërmarrë hapa cilësorë dhe sasiorë në drejtim të:

- ✓ Zhvillimit të hetimeve administrative pranë kontrolluesve publik dhe privat me fokus të veçantë fushat që kanë impakt më të madh në privatësi dhe që reflektojnë zhvillimet teknologjike në përpunimin e të dhënave personale. Qëllimi kryesor i Zyrës së Komisionerit është garantimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave dhe realizimi në praktikë i detyrimeve të kontrolluesve publik dhe privat. Hetimet administrative kanë synuar sensibilizimin e sektorëve specifikë mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave personale dhe evidentimin e problematikave gjatë proceseve përpunuese sektoriale me qëllim përmirësimin e tyre në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi.
- ✓ Përfshirjes së frymës dhe risive që sjell Rregullorja e Përgjithshme e BE-së (GDPR), në të gjitha proceset dhe mekanizmat e brendshëm, ato monitorues dhe mbikëqyrës. Kjo është reflektuar në teknikat inspektuese dhe të trajtimit të ankesave, por edhe në fushat e përzgjedhura për kontroll që përbëjnë interes ose trend edhe në nivel evropian. Rëndësi në këtë drejtim i është kushtuar edhe pjesëmarrjes në diskutime, tryezave të rrumbullakëta dhe planifikimit për zhvillim fushatash sensibilizuese në kuadër të risive që sjellë GDPR.

4.2 Trajtimi i ankesave

Gjatë vitit 2018 janë paraqitur **245** ankesa, nga të cilat **170** kanë rezultuar në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Për zgjidhjen e drejtë dhe të plotë të ankesave janë zhvilluar sipas rastit inspektime administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm si: Institucione financiare, Institucione të mbledhjes së borxhit, telekomunikacion, Drejtoria e Sigurimeve Shoqërore, media online etj, si dhe janë ndjekur të gjitha hapat procedurale sipas Kodit të Procedurave Administrative.


Ankesat janë paraqitur kryesisht lidhur me :

- ✓ Cënimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale (e drejta për akses, si një e drejtë e rëndësishme e subjektit të të dhënave, që lejon këtë të fundit, të marrë informacion nga kontrolluesi lidhur me përpunimin e të dhënave të tij);
- ✓ Përhapjen/transmetimin e të dhënave personale pa pëlqimin e subjektit të të dhënave personale si dhe në persona të paautorizuar, për të mbrojtur të dhënat personale;
- ✓ Përpunimin e të dhënave në mënyrë jo të drejtë dhe të ligjshme (përhapja në mediat dhe portalet online);

- ✓ Vendosjen e kamerave në ambiente publike dhe private;
- ✓ Marketingun e drejtpërdrejtë në lidhje me komunikimet e pakërkuara, nëpërmjet telefonit ose postës elektronike;
- ✓ Tejkalimin e afatit të mbledhjes së të dhënave personale për një qëllim të caktuar.


Një numër ankesash janë paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nëpërmjet postës elektronike të vendosur në dispozicion të subjekteve të të dhënave *info@idp.al* duke bërë të mundur komunikimin e shpejtë edhe të drejtpërdrejtë me subjektet, duke lehtësuar procedurën e zgjidhjes së ankesave.

Ankesa në vite 2014-2018




4.3 Hetimet administrative

Gjatë vitit 2018 janë realizuar **190** inspektime, nga të cilat **108** në terren, kurse **82** kanë qenë inspektime online për subjekte publike dhe private në faqet web në lidhje me detyrimin për informim të subjekteve të të dhënave, politikat e privatësisë etj. Nga inspektimet online, janë planifikuar edhe hetime administrative në terren për vitin 2019 në ato subjekte, të cilat nuk reflektojnë kërkesat e nenit 18, të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.



Janë kryer **108** inspektime në terren, **45** prej tyre në kontrollues publik dhe **63** në kontrollues privat. Nga vetë Zyra e Komisionerit (ex-officio) janë kryer **80** inspektime, ndërsa mbi bazë të ankesave janë kryer **28** inspektime.



Hetimet administrative me iniciativë në kontrollues publik dhe privat janë kryer lidhur me procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave në sektorë të tillë si:

- Institucionet Arsimore Parauniversitare Jo-Publike;
- Sektorin e furnizimit me ujë dhe përpunimit të ujërave të ndotura;
- Sektorin e Vlerësimit të Pasurive të Luajtshme e të Paluajtshme;
- Hoteleri;
- Sektorin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor.

Objekt i hetimit ka qenë “Zbatimi i ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij”.

Gjithashtu, janë kryer hetime administrative me iniciativë në kontrollues privat që realizojnë transferim ndërkombëtar të të dhënave personale në sektorin e shërbimit postar.

Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit ka ushtruar hetime administrative në kuadër të verifikimeve të zbatimit të Rekomandimeve të viteve 2016-2017. Nga **103** rekomandime të lëna në këto vite në kontrollues privat dhe publik, një numër i konsiderueshëm i kontrolluesve kanë reaguar duke dërguar informacion me përmbushjen e detyrimeve.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit ka ushtruar kontroll administrativ në **20** kontrollues publik për të verifikuar zbatimin e Rekomandimit të dalë ndaj tyre. Nga zhvillimi i këtyre hetimeve, **11** kontrollues janë sanksionuar me gjobë.

Në kuadër të verifikimeve të zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga Zyra e Komisionerit janë ushtruar hetime administrative në:

- Njësitë e Vetë-Qeverisjes Vendore;
- Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Me prioritet janë trajtuar edhe inspektimet pranë:

- **Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë**, lidhur me projektin “Për ndërtimin e databazës së të dhënave për kategoritë e subjekteve punonjës arsimore, prind, nxënës me qëllim organizimin më efektiv të punës, rritjen e ndërveprimit dhe bashkëpunimit në kohë reale, me synim arritjen e synimeve më të larta dhe përmirësimin e mëtejshëm të arsimit”, për plotësimin e formularit “Prindërit për çdo shkollë”;
- **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**, për implementimin e projektit të “Për ndërtimin e databazës së të dhënave me qëllim informimin e pacientëve për çështje që kanë të bëjnë me të reja në fushën e shëndetësisë, shërbimet e reja që do të ofrojnë sistemi shëndetësor, promocionin shëndetësor dhe për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve shëndetësore në institucionet publike, organizim më efektiv të punës, rritjen e ndërveprimit”.

Gjatë këtij viti janë zhvilluar dhe kanë përfunduar **48** seanca dëgjimore, në vijim të të cilave kanë dalë aktet përkatëse të Komisionerit. Seancat dëgjimore janë zhvilluar pasi kontrolluesit janë njoftuar paraprakisht dhe në respektim të të drejtës së subjekteve për t’u dëgjuar në zbatim të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Zyra e Komisionerit vlerëson gatishmërinë e kontrolluesve për të bashkëpunuar dhe për të përmbushur detyrimet ligjore në këtë fushë, megjithatë disa nga problematikat e konstatuara gjatë kësaj periudhe raportimi, në inspektimet e ushtruara janë lidhur me:

- ✓ Garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave personale;
- ✓ Garantimin e detyrimit për informim nga kontrolluesi lidhur me mënyrën e përpunimit;
- ✓ Garantimin e detyrimit për korrigjim dhe fshirje të të dhënave nga kontrolluesi;
- ✓ Shërbimet online dhe përpunimin e të dhënave personale në rrjet;
- ✓ Garantimin e detyrimit për njoftim;
- ✓ Garantimin e sigurtisë dhe konfidencialitetit nga kontrolluesit.

4.4 Rekomandime dhe Urdhra

Komisioneri në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” është shprehur me **29** Rekomandime për kontrollues publik dhe privat.

Zyra e Komisionerit është shprehur me **1** (një) Urdhër për “Fshirjen e përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale”, për një kontrollues privat.


Në këtë kontekst, nëpërmjet rekomandimeve dhe urdhrave është synuar të ndërgjegjësohet çdo kontrollues i të dhënave për të kryer përpunime në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, pa cënuar privatësinë e individit.

4.5 Sanksione administrative

Shkeljet për të cilat kontrolluesit janë sanksionuar me gjobë konsistojnë në mungesën e masave tekniko-organizative dhe hartimin e rregullores për përpunimin e të dhënave personale, mos nënshkrimin e deklaratës së konfidencialitetit me punëmarrësit të cilët kanë akses në të dhënat personale, rregullimin e marrëdhënieve me përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, mos publikimin e politikave të privatësisë në portalet zyrtare, mos informimin e subjekteve të të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) etj., detyrime të cilat burojnë nga ligji nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe aktet nënligjore të Zyrës së Komisionerit.


Sipas parashikimeve dhe procedurave ligjore, Zyra e Komisionerit pas ushtrimit të hetimeve administrative pranë kontrolluesve të ndryshëm publik dhe privat, kryesisht ose mbi bazë ankesash të subjekteve të të dhënave ka vendosur sanksione me gjobë. Kjo në rastet kur shkeljet kanë qenë serioze, të përsëritura, apo në rast mospërbushjeje të rekomandimeve/urdrave të Komisionerit, përpara marrjes së vendimit me sanksion.

Në mbyllje të procedurave hetimore, Zyra e Komisionerit ka dalë me **30** vendime me gjobë të cilat korrespondojnë me **61** sanksione administrative.



4.6 Njoftimi

Gjatë vitit 2018, në përbushje të detyrimit ligjor kanë njoftuar **116** subjekte kontrolluese. Numri i përgjithshëm i njoftimeve të përpunimeve nga kontrolluesit në territorin e Republikës së Shqipërisë deri tani ka arritur në **5517**. Numri i subjekteve kontrolluese të regjistruara në Regjistrin Qendror të Subjekteve Kontrolluese është **5457**.



4.7 Transferimi ndërkombëtar

Garantimi që të drejtat e subjekteve të të dhënave të mbrohen edhe në rastet kur të dhënat personale të tyre përpunohen jashtë territorit të vendit ku garantohet një nivel i mjaftueshëm i mbrojtjes së të dhënave përbën prioritet për Zyrën e Komisionerit.

Me indicie nga plotësimi i Formularëve të Njoftimit, në rastet ku është konstatuar se realizohet transferim në vende me nivel jo të mjaftueshëm është kërkuar informacion shtesë nga kontrolluesit dhe më tej janë shqyrtuar praktikatat përkatëse të transferimeve. Janë kryer hetime administrative në kontrollues privat për të monitoruar procesin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave.

Janë trajtuar **14** praktika për autorizimin e transferimit në disa shtete pa nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe janë dhënë **2** vendime për lejimin e transferimit ndërkombëtar në sektorë si: banka dhe në fushën farmaceutike në funksion të mbrojtjes më të mirë të të dhënave personale të qytetarëve. Në rastet e tjera, nuk ka qenë e nevojshme pajisja me autorizim nga ana e Zyrës së Komisionerit, dhe kontrolluesit janë orientuar dhe udhëzuar me qëllim zbatimin sa më të drejtë të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. TRAJTIMI I ANKESAVE SIPAS LIGJIT NR. 146/2014 “PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK”

Në përmbushje të detyrës për shqyrtimin e ankesave në lidhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, për vitin 2018, Zyra e Komisionerit ka trajtuar **3** ankesa:

- Rasti i parë me objekt ankimi “Për mosrespektim të procedurave ligjore për njoftimin dhe konsultimin dhe konsultimin publik për projektligjin “Për fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”. Akti i Komisionerit është ankimuar në gjykatë e cila në përfundim të procesit, vendosi shpalljen jashtë juridiksionit gjyqësor dhe dërgimin e akteve organit kompetent;
- Rasti i dytë me objekt ankimi “Ndaj vendimit të Këshillit Bashkiak Berat nr.31, datë 19.03.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB-në nr.57, datë 28.12.2015 “Për sistemimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Berat, i ndryshuar”. Ankesa në këtë rast rezultoi e bërë jashtë afatit ligjor;
- Rasti i tretë me objekt ankimi “Për anulimin e rritjes së çmimit të ujit të pijshëm nga Bashkia Vlorë” Për këtë ankesë Zyra e Komisionerit ka kthyer përgjigje me e-mail zyrtar. Rezulton që pala ankuese të mos këtë vijuar me ankimin.

Megjithëse ligji ka mbi 3 vjet që ka hyrë në fuqi, konstatojmë se ai nuk po zbatohet në nivelin e kërkuar nga organet publike, si dhe nuk po shërben si një mjet efektiv për qytetarët.

6. VEPRIMTARIA JURIDIKE, PROCEDURAT ADMINISTRATIVE DHE GJYQËSORE


6.1 Hartimi i akteve rregullatore

Për vitin 2018 në drejtim të zbatimit të detyrimeve që burojnë nga akte ligjore apo nënligjore është:

- miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.144, datë 13.3.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i subjekteve kontrolluese””; (botuar në Fletore Zyrtare nr. 37 , datë 19.03.2018);
- miratuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.145, datë 13.3.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore “Regjistri elektronik i kërkesave dhe i përgjigjeve për të drejtën e informimit””; (botuar në Fletore Zyrtare nr.37, datë 19.03.2018);
- miratuar Urdhri i Komisionerit nr.211, datë 10.09.2018 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”; (botuar në Fletore Zyrtare nr.133, e datë 17.09.2018);
- miratuar Udhëzimi i Komisionerit nr.47, datë 14.09.2018 “Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”. (botuar në Fletore Zyrtare nr.137, datë 25.09.2018);
- miratuar Udhëzimi i Komisionerit nr.48, datë 14.09.2018 “Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”. (botuar në Fletore Zyrtare nr.137, datë 25.09.2018).

6.2 Dhënie mendimi për projekt/akte

Bazuar në germën a), të pikës 1, të nenit 31, të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit ka dhënë mendime ligjore për **4** projekt/ligje, **12** projekt/vendime, **6** projekt/marrëveshje, **3** memorandume mirëkuptimi, **1** projekt/udhëzim si dhe janë dhënë një sërë opinionesh ligjore si dhe kthim përgjigje të paraqitura nga kontrollues publik e privat (Aneksi 1).



6.3 Monitorimi i Fletoreve Zyrtare

Ka vijuar kontrolli i fletoreve zyrtare për të evidentuar rastet e miratimit të projekt akteve ligjore dhe nënligjore për të cilat nuk është marrë mendimi i Zyrës së Komisionerit. Ky verifikim siç edhe kemi cituar në raportet e mëparshme bëhet me qëllim reflektimin e institucioneve në qasjen e legjislacionit që kërkojnë të miratojnë, me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Nga kontrolli i fletoreve zyrtare janë evidentuar **5 ligje, 5 Vendime të Këshillit të Ministrave dhe 1 udhëzim i Ministrisë së Arsimit**, që kanë të bëjnë me të dhënat personale dhe që janë miratuar pa u dërguar për mendim pranë Zyrës së Komisionerit (Aneksi 2).

6.4 Proceset gjyqësore

Në lidhje me vendimet e Komisionerit dhe zbatimin e tyre, bazuar në numrin e vendimeve të lëna në fuqi nga gjykata ose ekzekutimin e tyre edhe për këtë vit konstatohet një ecuri shumë pozitive.

Komisioneri për vitin 2018, në respektim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” është shprehur me **37 vendime**, ndër të cilat janë ankimuar dhe ndjekur **18 procese gjyqësore**, prej të cilave gjykata ka vendosur për **9 rrëzimin e kërkesë padisë dhe lënien në fuqi të vendimeve të Komisionerit, 3 pranim e kërkesë padisë, 2 pranimin e pjesshëm të kërkesë padisë, 1 pushimin e procesit gjyqësor ndërsa 3 çështje vijojnë të jenë në proces.**

E DREJTA PËR INFORMIM	
Viti	2018
Vendime	37
Sanksione	3
Procese Gjyqësore	18
Rrëzimin e padisë	9
Pranim të padisë	3
Pranim të pjesshëm padie	2
Pushim të procesit gjyqësor	1
Vijon procesi gjyqësor	3

Komisioneri për vitin 2018 në respektim të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, është shprehur me **30 vendime**. Nga këto **30 vendime**, për **8** vendime, kontrolluesit përkatës kanë ekzekutuar vullnetarisht sanksionet administrative. Për **7** vendime Zyra e Komisionerit ka kërkuar ekzekutimin përmbarimor. Ndërsa për **9** vendime, kontrolluesit kanë ngritur padi në gjykatë për të cilat është ndjekur procesi gjyqësor administrativ. Pas përfundimit të proceseve gjyqësore, gjykata për **6** çështje ka vendosur lënien në fuqi të vendimeve të Komisionerit, **1** çështje është pushuar, ndërsa vijon ndjekja për 2 çështje të tjera.

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE	
Viti	2018
Vendime	30
Sanksione administrative	61
Procese Gjyqësore	9
Rrëzimin e padisë	6
Pushim të procesit gjyqësor	1
Vijon procesi gjyqësor	2
Ekzekutime vullnetare	8
Ekzekutime me përmbarim	3
Kërkesë për ekzekutime përmbarimore	4
Në afat për të ekzekutuar vullnetarisht	11

Gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit ka ndjekur proceset gjyqësore në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe numri total i proceseve gjyqësore të ndjekura pranë kësaj gjykate është **22** çështje. Nga të cilat, **18** çështje vijojnë të jenë në proces, **3** çështje ku është lënë në fuqi akti i Komisionerit dhe **1** është rrëzuar.

7. NDËRGJEGJËSIMI DHE PROMOVIMI I TË DREJTËS PËR INFORMIM DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

7.1 Marrëveshje Bashkëpunimi

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2018, ka nënshkruar 4 marrëveshje bashkëpunimi me këto institucione:

- ✓ Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë, më 25.01.2018;
- ✓ “Ernst & Young Albania”, më 22.02.2018;
- ✓ Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Lirinë e Informimit të Landit Baden-Württemberg, në Gjermani, më 04.09.2018;
- ✓ Avokatin e Popullit dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, më 23.11.2018.

7.2 Bashkëpunim me OSBE

Zyra e Komisionerit në kuadër të projektit të bashkëpunimit me Prezencën e OSBE në Shqipëri ka organizuar në Korçë, Shkodër dhe Kukës takime me temë “E drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale, njohja me detyrimet e ligjeve respektive”. Aktivitetet kishin për qëllim trajnimin e përfaqësuesve të institucioneve qendrore në nivel vendor, të organeve të vetëqeverisjes vendore, atyre të sistemit të drejtësisë, etj., me fokus balancën ndërmjet dy të drejtave kushtetuese në funksion të veprimtarisë së tyre.

Pjesë e bashkëpunimit me Prezencën e OSBE në Shqipëri, ishte dhe bashkë-organizimi i aktivitetit me temë “Rregullat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor”. Ai kishte për qëllim ndërgjegjësimin e kontrolluesve publik dhe privat me rregullat e reja të vendosura në BE pas hyrjes në fuqi të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave 670/2016 (GDPR).

7.3 Bashkëpunimi me Projektin Star 2 të UNDP

Zyra e Komisionerit me asistencën e Projektit Star 2 “Suport për Reformën Administrative dhe Territoriale”, hartoi Programin Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore si dhe ndërmori një proces trajnimi për koordinatorët.

7.4 Bashkëpunimi me Shoqërinë Civile

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Fondacionin “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” organizuan “Konferencën IV Kombëtare për të drejtën e informimit - Për një ligj edhe më të mirë”. Në aktivitet morën pjesë përfaqësues dhe koordinatorë të së drejtës për informim të institucioneve qendrore, përfaqësues të autoriteteve të pavarura, të vetëqeverisjes vendore, të sistemit të drejtësisë, nga organizatat e shoqërisë civile, të medias, etj. Konferenca vlerësoi zbatimin e ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe

shqyrtimin e problematikave të konstatuara në përmbushjen e detyrimeve të tij nga Autoritetet Publike.

Në aktivitet u prezantuan 4 dokumenta: projekti i amendimeve të mundshme të ligjit 119/2014; iniciativat për përmirësimin e legjislacionit për mundësimin ligjor dhe praktik të komunikimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve me institucionet publike përmes portalit *pyetshet.in.al*; vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave për forcimin e statusit të koordinatorëve të së drejtës së informimit; si dhe instrumenti i vetëvlerësimit për institucionet e pavarura.

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me këtë fondacion, ka përfunduar implementimin e instrumentit të vetëvlerësimit të transparencës në institucionin e Presidentit, Kuvendit, Kryeministrit si dhe në të gjitha ministrinë dhe institucionet e pavarura. Në këtë kuadër u zhvilluan trajnime për të gjithë koordinatorët e të drejtës për informim dhe u hartua raporti përfundimtar dhe rekomandimet për secilin institucion.

7.5 Bashkëpunimi me ASPA

Edhe këtë vit ka vijuar bashkëpunimi me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike. E drejta për informim ka qenë pjesë e programit të trajnimit të detyruar për nëpunësit civil në periudhë prove, në të cilat kanë marrë pjesë 370 nëpunës civil.

7.6 Trajnime

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me Shoqatën Shqiptare të Bankave zhvilloi aktivitetin me temë “Rregullat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin bankar”, ku morën pjesë përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë dhe nga shoqëritë financiare jobankare. Në takim u prezantua legjislacioni kombëtar, veprimtaria e autoritetit dhe raste konkrete, si dhe risitë e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) të prezantuara nga një ekspert ndërkombëtar.

Zyra e Komisionerit në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, mbajti një leksion në seminarin me temë “Mbrojtja e të dhënave private dhe privatësia në raport me lirinë e shprehjes dhe zhvillimet teknologjike”. Në këtë seminar u trajtuan dhe tematikat mbi “Lirinë e shprehjes në këndvështrimin e të drejtës për informim dhe kufizimet e kësaj lirie në kuadër të mbrojtjes së të dhënave private” dhe “Mbrojtja e privatësisë në raport me lirinë e shprehjes”.

Komisioneri ka mbajtur prezantime për legjislacionin e të drejtës për informim dhe atë për mbrojtjen e të dhënave personale në Kursin e 3-të të “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike 2018” mbështetur nga Këshilli i Evropës si dhe në aktivitetin e organizuar nga Këshilli Shqiptar i Medias me temë: “Privatësia dhe mbulimi mediatik, sfidat e reja për respektimin e standardeve etike nga gazetarët e rinj”.

Zyra e Komisionerit prezantoi temën “Standardet dhe problematika e respektimit të të dhënave personale nga mediat shqiptare” në trajnimin e organizuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit zhvilloi në “Qendrën e

Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm” trajnimin mbi rritjen e njohurive për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

7.7 Të rinjtë

Zyra e Komisionerit organizoi “Shkollën Dimërore Informim dhe Privatësi” me pjesëmarrës studentë dhe staf akademik e administrativ të Universitetit Mesdhetar. Në këtë aktivitet u trajtuan tema që kanë të bëjnë me legjislacionin kombëtar të mbrojtjes së të dhënave personale dhe atë evropian, legjislacionin për të drejtën e informimit, si dhe raste nga veprimtaria e autoritetit. Gjithashtu, në Ditën e Mbrojtjes së të Dhënave Personale, u zhvillua një takim me nxënësit e shkollës së mesme “Ismail Qemali” në Tiranë.

Aktiviteti ndërgjegjësues për “Ditën e të drejtës për informim”, në 28 shtator u zhvillua në mjediset e Kryesisë së Kuvendit me pjesëmarrjen e nxënësve dhe mësuesve të shkollave të mesme të kryeqytetit. Ky aktivitet u bashkë-organizua nga Kuvendi, Zyra e Komisionerit, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) dhe Drejtoria Arsimore Rajonale e Tiranës.

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me “*Projektin e Binjakëzimit Anti Korrupsion*” zhvilloi takime në shkollat e mesme të qyteteve: Lushnjë, Berat, Durrës dhe Tiranë. Në këto takime u diskutua mbi çështjet e transparencës në administratën publike dhe parimet e mbrojtjes së privatësisë në internet.

Në kuadër të takimeve ndërgjegjësuese Zyra e Komisionerit mbajti prezantimet përkatëse, në workshop-in “Përshtatja e kërimit në TIK (Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit) për të mbështetur agjendën digjitale shqiptare”, organizuar nga Fakulteti i Shkencave të Natyrës të Universitetit të Tiranës.

Zyra e Komisionerit zhvilloi një trajnim pranë shkollës së mesme, jo publike “Turgut Ozal”. Në këtë takim, ku të pranishëm ishin mësues dhe stafi administrativ, u trajtua legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, ligji nr.19/2016 “*Për masat shitesë të sigurisë publike*” si dhe raste konkrete të trajtuara nga Zyra e Komisionerit.

Zyra e Komisionerit përmbylli fushatën ndërgjegjësuese “*Privatësi dhe Siguri*”, qëllimi i së cilës ishte konsultimi i “*Kuadrit të aftësisë të mësuesve të shkollave 9-vjeçare për mbrojtjen e të dhënave personale*”. Pjesëmarrës në këto konsultime ishin mësues të lëndëve të edukatës shoqërore, TIK dhe psikologë.

Gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit filloi fushatën ndërgjegjësuese “Luaj dhe Mëso – Happy Onlife”, me nxënësit e shkollës nëntë vjeçare të Tiranës. Loja është ideuar dhe realizuar nga Qendra Kërkimore e Bashkuar e Bashkimit Evropian, për të promovuar rregullat e arta për një përdorim më të sigurt dhe të përshtatshëm të internetit.

Në zbatim të “Agjendës Kombëtare të të Drejtave të Fëmijëve” për vitet 2017 -2018, është raportuar lidhur me treguesin dhe rezultatin mbi Komisionerin e të Drejtës për Informim

dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka dhënë mendim dhe është pjesë e grupit të punës për “Strategjinë e Drejtësisë për të Mitur”.

7.8 Takime të tjera

Zyra e Komisionerit zhvilloi një takim pune me një grup gazetarësh, përfaqësues të medias maqedonase, të cilët u njohën me rolin dhe funksionet e Zyrës së Komisionerit në mbikëqyrjen e ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Zyra e Komisionerit, zhvilloi një takim me zyrtarë të disa institucioneve të Republikës së Kosovës, i cili kishte në fokus shkëmbimin e eksperiencës dhe asistencën në kuadër të procesit të hartimit të legjislacionit të ri për të drejtën e informimit në këtë vend.


Zyra e Komisionerit priti një delegacion nga Republika e Maltës të kryesuar nga Sekretari i Parlamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit, në fushën e veprimtarisë të të cilit përfshihet edhe mbrojtja e të dhënave personale. Palët diskutuan për rrugët e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të eksperiencës me autoritetin homolog maltez, veçanërisht, pas hyrjes në fuqi të Rregullores së Re të Përgjithshme (GDPR) të Bashkimit Evropian.

7.9 Evente të rëndësishme

Me rastin e 28 Janarit, Ditës Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale, Zyra e Komisionerit zhvilloi ceremoninë e promovimit të pullës postare shqiptare. Emetimi i saj është një iniciativë e Zyrës së Komisionerit dhe përfaqëson në të gjithë elementët konceptin e mbrojtjes së privatësisë dhe marrëdhënien që ka sot individi me teknologjinë.

Zyra e Komisionerit në mars 2018 kremtoi 10-vjetorin e themelimit. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues të lartë nga institucionet qendrore, përfaqësitë diplomatike, shoqërisë civile, media si dhe të botës akademike. Gjatë këtij eventi Zyra e Komisionerit nënshkroi dhe marrëveshjen e bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit.

Në Zyrën e Komisionerit u zhvillua një takim me tematikë informuese dhe monitoruese, me Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Shqipërisë. Komisioneri i njohu të pranishmit për mbikëqyrjen dhe monitorimin e akteve rregullatore, veprimtarinë e kontrollit dhe hetimeve administrative në lidhje me procesin e mbledhjes/përpunimit të të dhënave personale nga kompanitë e mëdha publike dhe private dhe mbi ecurinë e transparencës së autoriteteve publike, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit qendror.



Janë zhvilluar 4 trajnime nga ekspertë të huaj për stafin dhe përfaqësues të institucioneve publike.

Gjatë vitit 2018, u publikuan numrat 5 dhe 6 të Revistës “*Informim Dhe Privatësi*”, botime në të cilat janë pasqyruar aktivitetet kryesore të Zyrës së Komisionerit.

8. VEPRIMTARIA NDËRKOMBËTARE DHE ORGANIZIMI I KONFERENCËS EVROPIANE TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE

8.1 Konferenca e Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave Personale – Tiranë 2018

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, organizoi në maj 2018 edicionin e 28-të të Konferencës së Autoriteteve Evropiane të Mbrojtjes së të Dhënave, me temë “*Data Protection – Better Together*”. Konferenca është forumi më i rëndësishëm i bashkëpunimit dhe koordinimit të strategjive dhe politikave të Autoriteteve Evropiane mbikëqyrëse të së drejtës për mbrojtjen e të dhënave dhe privatësisë. Në edicionin e organizuar në Tiranë u mbledhën rreth 100 përfaqësues nga autoritetet evropiane të mbrojtjes së të dhënave.

Konferenca trajtoi çështje që kanë të bëjnë me nisjen e zbatimit të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave dhe përpunimin e të dhënave në kuadër të veprimtarisë së organeve ligjzbatuese, raportin e këtij sistemi të ri rregullator me vendet e treta dhe forcimin e bashkëpunimit midis autoriteteve. Gjithashtu, u mbajtën prezantime mbi modernizimin e Konventës 108 të KiE-së, konvergjencën e standardeve evropiane të mbrojtjes së të dhënave në sisteme të tjera rregullatore, mbrojtjen e të dhënave në veprimtarinë humanitare, etj.

Gjatë punimeve të këtij forumi u diskutua dokumenti i përgatitur nga Grupi i Punës për të Ardhmen e Konferencës Evropiane, koordinator i së cilit ishte Zyra e Komisionerit dhe në përbërje të të cilit janë 12 Autoritete.

8.2 Shqipëria Organizatore e Konferencës së 41-të Botërore të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC)

Zyra e Komisionerit mori pjesë në Konferencën e 40-të Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë (ICDPPC) me temë: “*Debating Ethics: Dignity and respect in data driven life*”. Gjatë Konferencës u diskutuan propozimet e Grupit të Punës për reformimin e këtij forumi, ku Zyra e Komisionerit ka kontribuar në përgatitjen e disa prej dokumenteve kryesorë, siç është Projekt-Rezoluta mbi “*Udhërrëfyesin për të Ardhmen e Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë*”, “*Censusin e Konferencës*” etj.

Gjatë ceremonisë së akordimit të çmimeve “ICDPPC Awards”, iniciativa e Zyrës së Komisionerit: “**Pulla postare shqiptare e ditës së Mbrojtjes së të Dhënave**” u shpall fituese e “Çmimit Global për Privatësinë dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2018”, duke u përzgjedhur nga 43 projekte të tjera në kategorinë “Edukimi dhe ndërgjegjësimi publik”.

Zyra e Komisionerit është anëtare me të drejta të plota e organit drejtues, Komitetit Ekzekutiv të Konferencës Ndërkombëtare ICDPPC. Zyra e Komisionerit do të organizojë edicionin e 41-të të Konferencës Kombëtare ICDPPC, në Tiranë, në datat 21-24 tetor 2019.

8.3 Zyra e Komisionerit bashkëpunon me Instrumentin e Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX)

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me TAIEX-in, organizuan në datat 27-28 shkurt 2018, Mision Ekspertësh - *Mbi Përafrimin e Legjislacionit të Mbrojtjes së të Dhënave me të Drejtën e BE-së në Fushën e Mbrojtjes së të Dhënave* dhe në datat 14-15 nëntor 2018, Mision Ekspertësh - *Mbi Impaktin e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave në Vendet në Proces Anëtarësimi*.

Këto aktivitete u zhvilluan në kuadër të njohjes dhe implementimit të ndryshimeve të legjislacionit të brendshëm në përputhje me kuadrin e ri të mbrojtjes së të dhënave të BE-së. Zyra e Komisionerit përfshiu në këto trajnime edhe autoritete të tjera kombëtare, sikurse Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe Sigurisë Kibernetike. Gjithashtu, aktivitetet synuan trajnimin e stafit të Zyrës së Komisionerit, mbështetur dhe në rekomandimin e Raportit të KE-së 2016 për Shqipërinë, ku në Kapitullin 23, parashikohet se: “... numri i sesioneve të trajnimit të stafit të Zyrës së Komisionerit duhet rritur më tej.”

8.4 Bashkëpunimi me T-PD, EDPB dhe Grupin e Berlinit

Zyra e Komisionerit ka vijuar pjesëmarrjen në takimet e Grupit të Punës të Nenit 29 (WP29) deri në konstituimin e Bordit Evropian të Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB) pas nisjes së zbatimit të kuadrit të ri ligjor evropian në fushën e mbrojtjes së të dhënave, Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (Rregullores 2016/679) dhe Direktivës së Policisë (Direktivës 2016/680). Bordi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (EDPB), i cili është organi më i lartë i pavarur dhe vendimmarrës i Bashkimit Evropian në këtë fushë, i akordoi Zyrës së Komisionerit statusin e vëzhguesit të përhershëm pranë këtij organizmi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit ka vijuar pjesëmarrjen edhe në Mbledhjet Plenare të Komitetit Konsultativ të Konventës 108 të KiE-së dhe në mbledhjet e Grupit Ndërkombëtar të Punës për Mbrojtjen e të Dhënave në Telekomunikacione (Grupin e Berlinit).

8.5 Digital Clearing House

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mori pjesë për herë të parë në forumin “*Digital Clearinghouse*” të organizuar nga Mbikëqyrësi Evropian i Mbrojtjes së të Dhënave (European Data Protection Supervisor - EDPS). Me iniciativën e Zyrës së Komisionerit u organizua një delegacion ndër-institucional i

përbërë nga përfaqësues të Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të marrë pjesë në këtë forum.

Aktiviteti mbledhi përfaqësues të lartë të institucioneve nga shtetet anëtare të BE-së dhe përfaqësues nga Azia, Amerika Veriore dhe Amerika Jugore. U trajtuan një sërë temash që kanë të bëjnë me ndikimin e mundshëm të GDPR-së për të vonuar ose bllokuar hetimet e kryera nga autoritetet e konkurrencës dhe mbrojtjen e konsumatorit, manipulimi i proceseve zgjedhore nëpërmjet internetit dhe ndikimi në demokraci, rregullimi asimetrik i të dhënave dhe ndikimi në konkurrencë, etj.

8.6 Marrëdhënia me Eurojust

Me rëndësi për këtë vit ka qënë nënshkrimi i Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust, miratuar me ligjin nr.113/2018 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it”. Zyra e Komisionerit ka ofruar kontributin e saj duke qënë pjesë e negociatave me Eurojust.

Në këtë kuadër, nëpërmjet Projektit IPA 2017 “Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor” implementuar nga GIZ, ka filluar procesi i përgatitjes së hapave për implementimin e marrëveshjes në praktikë nëpërmjet ngritjes së infrastrukturës dhe mekanizmave përkatës rregullator dhe teknik nga ana e organit të prokurorisë, marrjen e masave konkrete, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e personelit të tyre për aplikimin e parimeve dhe detyrimeve ligjore mbi mbrojtjen e të dhënave personale gjatë procesit të tyre të punës.

Zyra e Komisionerit, në zbatim të nenit 19, të marrëveshjes ka një rol të rëndësishëm pasi monitoron gjendjen e zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje mbi realizimin e detyrimeve lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe raporton një herë në vit tek Oficeri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Eurojust.

Me mbështetjen e projektit, është ngritur një grup pune me përfaqësues të disa institucioneve si Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Zyra e Komisionerit dhe janë organizuar disa takime, lidhur me hapat që duhet të ndërmerren për implementimin e marrëveshjes.

Gjatë vitit 2019, pritet që të fillojë një proces intensiv trajnimesh, nga ana e ekspertëve të Zyrës së Komisionerit, me stafet e prokurorive kryesore në vend, lidhur me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, rëndësinë e caktimit të oficerit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe rolin e tij, detyrimet ligjore në këtë fushë (sa i përket sigurisë së të dhënave, detyrimeve në cilësinë e kontrolluesit dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave) dhe implementimin e tyre në praktikë gjatë veprimtarisë procedurale hetimore.

Synimi kryesor mbetet arritja e standardeve të mbrojtjes së të dhënave personale nga ana e organit të prokurorisë me qëllim kalimin me sukses të vlerësimit që pritet të kryhet këtë vit dhe marrjen e miratimit nga Eurojust.

9. MENAXHIMI BUXHETOR

9.1 Zhvillimi i Kapaciteteve Institucionale

Caktimi i objektivave, ushtrimi i veprimtarisë dhe zbatimi i politikave të burimeve njerëzore, synojnë të krijojnë një mjedis pune motivues duke sjell ndër të tjera rritjen profesionale të punonjësve, adoptimin e standardeve më të mira në këtë fushë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve administrative të institucionit.

Në zbatim të objektivave strategjike të institucionit, politika e administrimit të burimeve njerëzore është fokusuar në drejtim të përvetësimit dhe zbatimit në vazhdimësi të praktikave më të mira të menaxhimit të burimeve njerëzore që aplikohen në institucionet homologe të Bashkimit Evropian. Ndjekja e politikave proaktive të punësimit, menaxhimit dhe promovimit në karrierë të kapaciteteve njerëzore për një organizim strukturor profesional dhe fleksibël, mbetet një prioritet i institucionit.

Këto politika synojnë, kryesisht, në racionalizimin e strukturës organizative dhe përmirësimin e efektivitetit të Zyrës së Komisionerit, në linjë me objektivat strategjike të saj dhe kuadrin ligjor përkatës. Përfaqësimi gjinor, në nivel specialistësh dhe drejtuesish, është i ekuilibruar. Raporti i femrave ndaj meshkujve në totalin e punonjësve (nëpunës civil dhe të kontraktuar të përkohshëm) është 60%-40%, ndërkohë që ky raport vetëm në nivel drejtuesi është 70%-30%.

Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit. Zyra e Komisionerit ka qenë pjesë aktive dhe pjesëmarrëse në trajnimet e organizuara nga ASPA, por ndërkohë edhe përfaqësuese, në cilësinë e trajnerëve, për të njohur nëpunësit e administratës publike me detyrimet ligjore që burojnë nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Në zbatim të Planit Vjetor të Trajnimeve, punonjësit janë përfshinë në një proces trajnimesh, brenda dhe jashtë vendit, duke bërë të mundur shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikatat më të mira.

9.2 Struktura Organizative

Si rezultat i kërkesave të përsëritura vit pas viti për mbështetje me burime njerëzore, me ligjin nr.109/2017 “Për Buxhetin e vitit 2018”, si dhe mbështetur në vendimin nr.86/2018 “Për Miratimin Strukturës, Organikës dhe Klasifikimin e Pagave të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Zyrës së Komisionerit i është miratuar numri total prej 37 punonjësish, krahasimisht me 35 punonjës të një viti më parë.


Konkretisht shtesa me 2 inspektorë është realizuar në Drejtorinë për të Drejtën e Informimit, në mënyrë që monitorimi dhe zbatimi i ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” të arrihet në mënyrën e duhur. Këto ndryshime synuan gjithashtu

përmirësimin dhe forcimin e disa proceseve të rëndësishme, përshtatjen më të mirë të strukturave me detyrat specifike që burojnë nga objektivat dhe veprimtaria e institucionit.

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

STRUKTURA ORGANIZATIVE

LIDHJA Nr.1



Zbatimi dhe respektimi i legjislacionit të shërbimit civil ka qenë një nga aspektet kryesore të menaxhimit në tërësi. Gjatë vitit 2018, janë ndjekur **7** procedura rekrutimi, **4** prej të cilave kanë qenë të nivelit të ulët drejtues, ndërsa janë plotësuar pozicionet e lira, në zbatim të ligjit për shërbimin civil.

Zyrës së Komisionerit, ju mundësua edhe gjatë vitit 2018 rekrutimi i 6 (gjashtë) punonjësve me kontratë të përkohshme pune.

Me rritjen e veprimtarisë dhe kompetencave të Zyrës së Komisionerit, është kërkuar shtimi i kapaciteteve, të cilat janë bërë prezentë gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA).

Shtimi i kapaciteteve, mbetet domosdoshmëri duke iu referuar kërkesave të argumentuara në PBA, të paktën duke shtuar numrin edhe me 9 punonjës të tjerë.

9.3 Të ardhurat dhe shpenzimet

Nga fondi i përgjithshëm buxhetor i planifikuar për vitin 2018, me ndryshimet e kryera gjatë vitit, Zyra e Komisionerit ka shpenzuar **vlerën buxhetore 67.029 (në mijë lekë)**.

Është realizuar buxheti në tërësinë e tij në masën rreth 97%, kundrejt planit vjetor, të ndryshuar ose me të njëjtën përqindje realizimi me një vit më parë.

Për vitin 2018, për mbulimin e disa projekteve specifike, zyra e Komisionerit është mbështetur financiarisht, si në shpenzime operative ashtu edhe me investime.

Në zbatim të planit për shpenzime dhe investime, Zyra e Komisionerit ka hartuar e zbatuar edhe planin e prokurimeve, i cili gjatë vitit 2018 përmbante 3 procedura prokurimi me tenderim. Ndërkohë mbulimi i nevojave të tjera është realizuar nëpërmjet prokurimeve me vlera të vogla.

Në grafikun e mëposhtëm pasqyrohet në %, çdo kategori shpenzimesh përkundrejt totalit të buxhetit, si dhe realizimi në % dhe vlerë i secilës kategori shpenzimesh, përkundrejt buxhetit të akorduar.

TABELA E AKORDIMIT TË BUXHETIT DHE REALIZIMIT

VITI 2018

në 000 / lekë

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	% kundrejt totalit	Fakt 12 muor	% realizimi kundrejt planit vjetor
1	Paga	37.800	54.5 %	37.029	97.9 %
2	Sigurime shoqërore	6.300	9.1 %	5.952	94.4 %
3	Mallra e shërbime të tjera	20.660	29.8%	19.537	94.6 %
4	Investime	4.000	5.9 %	3.996	100 %
5	Të tjera transferta tek individët	440	0.6%	440	100 %
6	Kuotizacion	100	0.1%	79	79 %
	Totali	69.300	100%	67.033	96.7 %

Mosrealizimet në zërat e shpenzimeve (operative) kanë ardhur si pasojë e rezultateve pozitive të prokurimeve, ndërsa për shpenzimet e tjera (pagë dhe sigurime) kanë ardhur si rezultat i përsëritjes së procedurave të rekrutimit dhe të paaftësisë së përkohshme në punë.

Fondet e siguruar nga donatorët dhe te administruar nga Zyra e Komisionerit, si më poshtë vijon:

	Mbartur	Krijuar	Përdorur	Trashëguar
Shpenzime operative	46 (në mijë lekë)	473 (në mijë lekë)	490 (në mijë lekë)	30 (në mijë lekë)
Shpenzime kapitale	2.045 (në mijë lekë)	0	0	2.045 (në mijë lekë)

Fondet e donatorëve mbarten nga viti në vit të cilat përdoren sipas destinacionit “Mbështetje për aktivitetet dhe infrastrukturën e Zyrës së Komisionerit”.

Ndërkohë Zyra e Komisionerit është përfituese direkte e shërbimeve me fondet e administruara nga Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” sipas objektit dhe vlerave të kontratave si më poshtë:

1. “Monitorimi i situatës së transparencës në institucionet e pavaruara” për periudhën dhjetor 2017- korrik 2018, me vlerën 25.427 USD.
2. “Krijimi i regjistrit kombëtar të digitalizuar të kërkesave për informim publik dhe integrimi në sistem i institucioneve publike” për periudhën 15 dhjetor 2017 – 01 korrik 2018, me vlerë 26.350 euro.
3. “Zhvillimi i regjistrit kombëtar të kërkesave për informacion dhe implementimi e tij ne 20 institucione të tjera” për periudhën 07.06.2018 - 06.06.2019, me vlerën 16.800 USD.
4. “Mirëmbajtja e portalit pyetshtetin.al” për periudhën 12 mujore, nga data 15.01.2018-15.01.2019 me vlerën 1200 euro.

Në strukturën e Zyrës së Komisionerit nuk ka njësi të auditit të brendshëm. Për vitin 2018 nuk jemi përfshirë në planin e auditimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Të ardhurat nga sanksionet/gjoba

Totali i Sanksioneve në Vitin 2018	2300 (në mijë lekë)
Për shkelje të dispozitave të ligjit nr.9887/2008, i ndryshuar	1850 (në mijë lekë)
Për shkelje të dispozitave të ligjit nr.119/2014	450 (në mijë lekë)

Për vitin 2018, sanksionet e vendosura janë në shumën 2.300 (në mijë lekë).

- Për sanksionet e vëna në vitin 2018, vlera e arkëtuar është në shumën 720 (në mijë lekë).
- Në vitin 2018 është arkëtuar edhe shuma 682 (në mijë) lekë gjoba, të vendosura në vitin 2016 dhe 2017.

Shuma totale e arkëtuar në vitin 2018 është 1402 (në mijë) lekë .

Viti	Shuma e gjobave në vite 2017-2018	
	Të arkëtuara	Të pa arkëtuara
2017	2590 (në mijë lekë)	159 (në mijë lekë)
2018	1402 (në mijë lekë)	1580 (në mijë lekë)
Totali	3992 (në mijë lekë)	1739 (në mijë lekë)

10. PROGRES RAPORTI I BE-SË PËR SHQIPËRINË MBI ZYRËN E KOMISIONERIT

Në Progres Raportin për Shqipërinë të publikuar në datë 17.4.2018 nga Komisioni Evropian, në kapitullin e dytë “Kapitujt Kriteret Politike dhe Rregullat e Ligjit” evidentohet dhe vlerësohet respektimi i të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Për sa më sipër, disa nga paragrafët parashikuar nga ky raport për Zyrën e Komisionerit janë:

*(Raporti i EC për Shqipërinë 2018- faqja nr. 11): “Për sa i përket **pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen lokale**, është bërë progres i mëtijshëm në fushën e **aksesit në informacion**: një numër në rritje ***bashkish kanë publikuar informacionin publik dhe kanë caktuar një përgjegjës lokal për të drejtën e informimit.***”*

Referuar këtij parashikimi, raportojmë se progresi i bërë, i konkretizuar në shifra është i tillë: **61** Bashki kanë Koordinator për të drejtën e informimit, **9** Këshilla Qarku dhe Prefektura kanë Koordinator për të drejtën e informimit, **37** Bashki dhe **10** Këshilla Qarku e Prefektura kanë Program Transparence.

*(Raporti i EC për Shqipërinë 2018- faqja nr. 15) : **E drejta për akses në informacionin publik** rregullohet me Ligjin për të Drejtën e Informimit, por zbatimi i saj ka zbuluar mangësi në kuadrin ligjor. Gjithnjë e më tepër autoritete publike kanë miratuar programe transparence, por duhen bërë më tepër përpjekje për të nxituar publikimin proaktiv të informacionit nga ana e institucioneve publike. **Kapaciteti i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për të monitoruar procesin duhet të rritet.***

Gjatë vitit 2018 Zyrës së Komisionerit i është miratuar numri total prej **37 punonjësve**. Shtesa me **2** punonjës ka ardhur si rezultat i kërkesave të përsëritura, gjatë paraqitjes së kërkesave buxhetore të PBA-së, për mbështetje në burime njerëzore ***në strukturën që mbulon drejtorinë për të drejtën e informimit.***

*(Raporti i EC për Shqipërinë 2018-faqja nr. 23): Në lidhje me **aksesin në informacion**, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka marrë 684 ankesa dhe ka nxjerrë 36 vendime në 2016-ën, ndërsa në 2017-ën ka marrë 560 ankesa. Është ngritur një sistem për të regjistruar numrin e kërkesave që u bëhen institucioneve publike.*

Gjatë vitit 2018, për respektimin e të drejtës për informim, Zyra e Komisionerit ka trajtuar **820** ankesa, çka vërehet tendencë në rritje në krahasim me vitin e kaluar **560 ankesa**. Ndërsa për sa i përket “Regjistrin elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”, numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet sistemit është **237** në periudhën mars – dhjetor 2018, (kohë në të cilën ka nisur funksionimi i këtij regjistri).

(Raporti i EC për Shqipërinë 2018-(faqja nr. 26-27):Në lidhje me **mbrojtjen e të dhënave personale**, vendi ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Personave nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale dhe protokollin shtesë të saj. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka shtuar stafin dhe programet e trajnimit. Komisioneri ka marrë 120 ankesa nga subjektet e të dhënave, ka kryer 184 inspektime administrative, ka nxjerrë 22 vendime dhe ka vendosur 36 sanksione administrative në 2016-ën. Duhet bërë përpjekje të mëtejshme për të harmonizuar legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Direktivën për mbrojtjen e personave fizikë.

Në zbatim të përmbushjes dhe realizimit të PKIE 2018-2020, është parashikuar transpozimi i rregullores së Rregullores së BE-së 2016/679 (GDPR) dhe Direktivës së Policisë 2016/680 duke amenduar ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” në periudhën: **tre mujori i tretë të vitit 2020**. Gjithashtu Komisioneri është përfutur i asistencës së programit IPA 2017 sipas aktivitetit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me acquis të BE-së për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave. Ky projekt pritet të fillojë zbatimin e tij gjatë 3 muajve të parë të vitit 2019.

(Raporti i EC për Shqipërinë (faqja nr. 28):Aksesi në informacion në lidhje me kontratat e prokurimit, auditimet dhe pagat e zyrtarëve duhet përfortuar. Vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit nuk janë detyruese për zyrtarët e administratës publike.

Zyra e Komisionerit ka përgatitur amendimet e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në të cilat do të përfshihet edhe ky parashikim, i cili ka dalë si problematikë e zbatimit të këtij ligji.

(Raporti i EC për Shqipërinë (faqja nr. 41) : Shqipëria ka vazhduar të intensifikojë bashkëpunimin gjyqësor për çështje civile dhe penale, përfshirë edhe me Shtetet Anëtare të BE-së. Ajo i ka adresuar rekomandimet e Eurojust-it në lidhje standardet e mbrojtjes së të dhënave dhe një projekt-marrëveshje bashkëpunimi është depozituar nga ana e Eurojust-it tek Këshilli për miratim.

Në kuadër të Marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Eurojust, me rëndësi për këtë vit ka qënë nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje, miratuar me ligjin nr. 113/2018 “Për Ratifikimin e Marrëveshjes për Bashkëpunimin ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe EUROJUST-it”, Zyra e Komisionerit ka dhënë kontributin e saj në këtë drejtim duke qënë pjesë e negociatave të nënshkrimit dhe aktualisht zbatimit të saj.

Në këtë periudhë, me mbështetjen e projektit IPA 2017 “Lufta kundër krimeve të rënda në Ballkanin Perëndimor” implementuar nga GIZ (Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit), është ngritur një grup pune me përfaqësues të disa institucioneve si Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Zyrës së Komisionerit të cilët po përcaktojnë hapat që do të ndiqen.

Zyra e Komisionerit, në zbatim të nenit 19 të marrëveshjes ka një rol të rëndësishëm pasi monitoron gjëndjen e zbatimit të dispozitave të kësaj marrëveshjeje mbi realizimin e detyrimeve lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe raporton një herë në vit tek Oficeri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Eurojust.

Në vijim gjatë vitit 2019 pritet që të fillojë një proces intensiv trajnimesh, nga ana e ekspertëve të Zyrës së Komisionerit, me stafet e prokurorive kryesore në vend, lidhur me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale, rëndësinë e caktimit të oficerit të mbrojtjes së të dhënave personale dhe rolin e tij, detyrimet ligjore në këtë fushë (sa i përket sigurisë së të dhënave, detyrimeve në cilësinë e kontrolluesit dhe garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave) dhe implementimi i tyre në praktikë gjatë veprimtarisë procedurale hetimore. Ky proces pritet që të mbështetet edhe nga projekti GIZ.

11. PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE

Raportime

Në kuadër të përfshirjes së kontributit të Zyrës së Komisionerit dhe hartimit të raporteve janë përgatitur:

- Raporti për Ministrinë e Evropës dhe Punët e Jashtme mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për vitin 2017 dhe tremujorin e parë të vitit 2018, në kuadër të takimit të 10-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”;
- Raporti për Komisionin Evropian në kuadër të Kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, mbi procesin “Screening”, si dhe u bë prezantimi i *acquis* për Kapitullin 23 të Progres Raportit për Shqipërinë, në datat 27-28 shtator 2018 pranë Ministrisë së Drejtësisë;
- Raporti mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për periudhën 1 janar 2018-30 shtator 2018, dhe të dhëna statistikore për të gjithë vitin 2017, në kuadër të hartimit të kontributit të parë të Qeverisë shqiptare për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2019.
- Raporti mbi informacionet shtesë të kërkuara nga shërbimet e Komisionit Evropian në kuadër të takimit të 9-të të Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri, Tiranë 25 tetor 2018;
- Raporti në kuadër të hartimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2019–2021, mbi pjesën narrative në Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” si dhe mbi planifikimin e akteve ligjore dhe dokumenteve strategjike që synojnë përafrimin me legjislacionin e BE-së;
- Raporti mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për vitin 2017 dhe tremujorin e parë të vitit 2018, në kuadër të takimit të 10-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Drejtësia, Liria dhe Siguria”, dërguar ministrisë së Evropës dhe Punët e Jashtme.
- Raporti për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme mbi informacionet shtesë të kërkuara nga shërbimet e Komisionit Evropian në kuadër të takimit të 9-të të Komitetit të Stabilizim-Asociimit Bashkimi Evropian – Shqipëri;
- Raporti periodik në kuadër të pjesëmarrjes në Grupin e Berlinit;
- Raporti në kuadër të përgatitjes së takimit të mekanizmit për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura, raportuar pranë Kuvendit të Shqipërisë lidhur me nivelin e zbatimit të Rekomandimeve.

12. NIVELI I ZBATIMIT TË REZOLUTËS SË KUVENDIT 2017

Zyra e Komisionerit si institucion i pavarur i cili i nënshtrohet detyrimit për raportimin në Kuvendin e Shqipërisë si dhe në funksion të zbatimit të Vendimit nr.49/2017 “Për monitorimin e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të atyre të krijuara me ligj të veçantë”, më poshtë rendit zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të vitit 2017 për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit.

Kuvendi i Shqipërisë, për vitin 2018, kërkon nga Zyra e Komisionerit:

1. Të angazhohet maksimalisht si institucion përgjegjës për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga VKM “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore, regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit”.

“Realizuar plotësisht” – “Regjistri elektronik i kërkesave dhe përgjigjeve për të drejtën e informimit” është instaluar në 27 Autoritete Publike, ndër të cilat 20 institucione qendrore si: Kryeministria; Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Brendshme; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Drejtësisë; Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë; Ministria e Kulturës; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Banka e Shqipërisë; Kontrolli i Lartë i Shtetit; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Komisioni Qendror i Zgjedhjeve; Agjencia e Prokurimit Publik; Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore; Policia e Shtetit; Qendra Kombëtare e Biznesit, dhe në 7 njësitë e qeverisjes vendore si: Bashkia Tiranë; Durrës; Elbasan; Fier; Korçë; Lezhë dhe Shkodër.

Në këtë kuadër, janë zhvilluar trajnime për koordinatorët dhe stafin IT të këtyre institucioneve të cilët u pajisën dhe me një manual lidhur me përdorimin e sistemit. Numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nëpërmjet sistemit është 237 në periudhën mars – dhjetor 2018, (kohë në të cilën ka nisur funksionimi i këtij regjistri) ndërsa në po të njëjtën periudhë numri i ankesave drejtuar Zyrës së Komisionerit është 50 në total.

2. Të rrisë hetimet proaktive me iniciativë lidhur me procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve nga kompanitë e mëdha publike dhe private.

“Realizuar plotësisht” - Gjatë vitit 2018 janë kryer 80 inspektive me iniciativë në sektorë të tillë si:

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- Institucionet Arsimore Parauniversitare Jo-Publike;
- Sektorin e furnizimit me ujë dhe përpunimit të ujërave të ndotura;
- Sektorin e Vlerësimit të Pasurive të Luajtshme e të Paluajtshme;
- Hoteleri;
- Sektorin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor;

- Sektorin e shërbimit postar.

Objekt i hetimit ka qenë “Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij”.

3. **Të rrisë masat administrative për shkelje ligjore të konstatuara, për mungesën e programeve të transparencës, regjistrin të kërkesave dhe përgjigjeve dhe caktimin e koordinatorit, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit qendror.**

“Realizuar plotësisht” - Të gjitha ministritë kanë përgatitur dhe miratuar programin e transparencës, regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve si dhe kanë caktuar koordinator për të drejtën e informimit.

4. **Të angazhohet për pasurimin e programeve të transparencës së institucioneve publike dhe jopublike, me informacione që kanë të bëjnë me objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm, në kuadër dhe të rezolutës së Kuvendit të dhjetorit 2017 “Për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm të agjendës të 2030 shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara”.**

“Realizuar plotësisht” - Zyra e Komisionerit, në asistencën e dhënë autoriteteve publike në hartimin e programeve të transparencës i ka kushtuar vëmendje të posaçme përfshirjes së informacionit që lidhet me objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm sipas objektivave dhe treguesve të synuar të përcaktuar në pasaportën e indikatorëve të strategjisë.

5. **Të angazhohet për hartimin e projektakteve normative që përafrojnë plotësisht dispozitat e paketës së re ligjore të BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale: Rregulloren (BE) 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale) dhe Direktivën (BE) 2016/680 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, të datës 27 prill 2016 (Direktiva për mbrojtjen e të dhënave të personave fizikë gjatë procesit penal).**

“Realizuar plotësisht” - Në kuadër të këtij procesi Zyra e Komisionerit është përfituese e asistencës së programit IPA II 2017 sipas aktivitetit “Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me *acquis* të BE-së për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave”.

Në zbatim të përmbushjes dhe realizimit të Planit Kombëtar të Integritetit Evropian 2018 – 2020 (PKIE), është parashikuar miratimi i ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe transpozimi i Rregullores së GDPR-së dhe Direktivës së Policisë në tre mujorin e tretë të vitit 2020.

Gjithashtu janë realizuar 6 trajnime mbi përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave me *acquis* të BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave.

6. Të rrisë kontrollet dhe hetimet administrative lidhur me respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

“Realizuar plotësisht” - Gjatë vitit 2018, për respektimin e të drejtës për informim, Zyra e Komisionerit ka trajtuar **820** ankesa, nga **560** ankesa të trajtuara në vitin 2017. Janë dërguar pranë autoriteteve publike **195** kërkesa për parashtrime, janë kryer **93** hetime administrative, **29** seanca dëgjimore dhe janë dhënë **37** vendime.

Lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale janë paraqitur **245** ankesa nga **205** ankesa të paraqitura për vitin 2017. Janë kryer **190** inspektive, ndër të cilat **82** inspektive online. Ndërsa nga **108** inspektive në terren, **45** prej tyre në kontrollues publik dhe **63** në kontrollues privat. **28** inspektive janë iniciuar në bazë të ankesave, ndërsa **80** inspektive janë kryer me iniciativë nga Zyra e Komisionerit. Janë zhvilluar **48** seanca dëgjimore, janë dhënë **30** vendime, **29** rekomandime dhe **1** urdhër.

7. Të hartojë dhe të miratojë modelin e programit të transparencës për organet e vetëqeverisjes vendore.

“Realizuar plotësisht” - Është miratuar Urdhri nr. 211, datë 10.9.2018 “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”. (botuar në Fletore Zyrtare nr.37, datë 19.03.2018).

8. Të monitorojë në vazhdimësi mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” mbi planin tematik, duke synuar unifikimin e praktikave në sektorë të ndryshëm.

“Realizuar plotësisht” - Është monitoruar në vazhdimësi mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” mbi plane tematike, duke unifikuar praktikat në sektorë të ndryshëm si: Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Institucionet Arsimore Parauniversitare Jo-Publike; Sektorin e furnizimit me ujë dhe përpunimit të ujërave të ndotura; Sektorin e Vlerësimit të Pasurive të Luajtshme e të Paluajtshme; Hoteleri; Sektorin e Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor dhe në Sektorin e shërbimit postar.

Në përfundim të kontrolleve, Zyra e Komisionerit ka dalë me Rekomandime Unifikuese për:

1. Ministrinë e Drejtësisë në lidhje me kontrollet e ushtruara pranë shërbimit Përmbartimor Gjyqësor;
2. Shoqatën e Vlerësuesve të Pasurive të Luajtshme dhe të Paluajtshme, në lidhje me kontrollet e ushtruara pranë vlerësuesve të pasurive.

9. Të monitorojë zbatimin e rekomandimeve/urdhrave të dhëna nga Zyra e Komisionerit, me fokus institucionet publike.

“Realizuar plotësisht” - Gjatë këtij viti, Zyra e Komisionerit ka ushtruar hetime administrative në kuadër të verifikimit të zbatimit të Rekomandimeve të viteve 2016-2017. Nga **103** rekomandime të lëna në këto vite në kontrollues privat dhe publik, një

numër i konsiderueshëm i kontrolluesve kanë reaguar duke dërguar informacion me përmbushjen e detyrimeve.

Ndërkohë, Zyra e Komisionerit ka ushtruar kontroll administrativ në **20** kontrollues publik për të verifikuar zbatimin e Rekomandimit të dalë ndaj tyre. Nga zhvillimi i këtyre hetimeve,

11 kontrollues janë sanksionuar me gjobë.

10. Të rrisë aktivitetet ndërgjegjësuere me autoritetet publike, qytetarët, kontrolluesit publikë e privatë, shoqërinë civile, për të dy fushat e veprimtarisë që mbulon Zyra e Komisionerit, të dhënat personale dhe të drejtën e informimit.

“Realizuar plotësisht” - Zyra e Komisionerit ka zhvilluar **36** aktivitete të ndryshme me qëllim ndërgjegjësimin dhe promovimin e të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale. Ndër këto aktivitete, citojmë si më poshtë vijon:

- Aktiviteti me kontrollues publik në Korçë, Shkodër, dhe Kukës;
- Takime sensibilizuese me nxënës dhe mësues të shkollave 9 vjeçare në Durrës, Lushnjë, Berat, Fier, Vlorë dhe DAR Tiranë në kuadër të fushatës “Privatësi dhe Siguri”;
- Konferenca IV Kombëtare “Për të Drejtën e Informimit”;
- Forumi anti-korrupsion;
- Aktiviteti me rastin e 28 janarit “Ditës ndërkombëtare të mbrojtjes së të dhënave personale”;
- 28 shtatori, dita e të drejtës për informim, takimi me gjimnazistët në Kryesinë e Kuvendit;
- Trajnim për instrumentin e vetëvlerësimit me koordinatorët;
- Trajnim në COD në kuadër të Projektit të binjakëzimit anti-korrupsion;
- Trajnim me koordinatorët (27 institucionet) për instalimin e sistemit për kërkesë/ankesat;
- Projekti i binjakëzimit anti-korrupsion me punonjës të Autoritetit të Konkurrencës, KQZ, Zyrës së Komisionerit dhe Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
- Trajnimi në shkollën “Turgut Ozal”;
- Shkolla Dimërore “Informim dhe Privatësi”;
- Trajnim me sektorin bankar;
- Trajnim me sektorin shëndetësor;
- Trajnim me nxënësit e gjimnazit “Ismail Qemali”, Tiranë;
- Trajnim me studentët e Universiteti “Ismail Qemali”, Vlorë;
- Leksion në kuadër të Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës;
- “Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike 2018”;
- Trajnim me temë: “Mbrojtja e të Dhënave Personale”, për Avokatë anëtarë të Dhomës së Avokatisë Tiranë, zhvilluar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë;

- Trajnim mbi rritjen e njohurive të personelit të "Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm" në drejtim të çështjeve të hartimit të programit të transparencës, si dhe zbatimit të detyrimeve ligjore;
- Aktivitet me temë *“Rregullat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e kujdesit shëndetësor”*, në vijim të bashkëpunimit me Prezencën e OSBE në Shqipëri;
- Aktivitet me temë *“Rregullat në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin bankar”* me Shoqatën Shqiptare të Bankave;
- Fushatë ndërgjegjësuere “Luaj dhe Mëso – Happy Onlife” pranë “Shkollës së Kuqe;
- Festivali shqiptar i filmit anti-korrupsion, me temë “Në lëvizje–In motion”. Aktiviteti u organizua në formën e një guide ndërgjegjësuere, pjesë e të cilit ishte edhe Zyra e Komisionerit.

11. Të forcojë kapacitetet institucionale nëpërmjet trajnimeve dhe bashkëpunimit me organizmat ndërkombëtarë.

“Realizuar plotësisht” - Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Janë zhvilluar **8** aktivitete me mbështetjen dhe bashkëpunimin me organizmat ndërkombëtarë.

Zyra e Komisionerit është pjesë e Projektit të Binjakëzimit Anti-korrupsion Shqipëri-Bashkimi Evropian, nëpërmjet së cilit janë zhvilluar trajnimet me temë: *“Transparenca në Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të BE (GDPR)”*; *“Direktiva e BE 680/2016”*.

Është punuar në vazhdimësi për rritjen e kapaciteteve dhe ngritjen profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit. Janë zhvilluar aktivitete me mbështetjen e Instrumentit të Asistencës Teknike për Shkëmbimin e Informacionit të Bashkimit Evropian (TAIEX) ndër të cilat:

- Misioni i ekspertëve *“Mbi përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave me të drejtën e BE-së në fushën e mbrojtjes së të dhënave”*;
- Misioni i ekspertëve *“Mbi impaktin e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave në vendet në proces anëtarësimi”*.

13. NEVOJA PËR NDRYSHIME NË KUADRIN LIGJOR QË RREGULLON VEPRIMTARINË E INSTITUCIONIT

13.1 Përafrimi i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren 2016/679 dhe Direktivën 2016/680 e BE

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian, prioritet mbetet nevoja për të përafruar legjislacionin në fuqi të mbrojtjes së të dhënave personale me atë të ***Acquis Communautaire***.

Rregullorja (BE) 2016/679 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 27 prill 2016, “*Mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave dhe shfuqizimin e Direktivës 95/46/EC*” (Rregullore e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave ose GDPR) u miratua në datën 14 prill 2016 nga Parlamenti Evropian dhe hyri në fuqi më **25 maj 2018**. Përafrimi dhe harmonizimi i legjislacionit kombëtar me këtë akt evropian dhe me Direktivën (BE) 2016/680 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 27 prill 2016 “*Mbi mbrojtjen e personave fizikë në lidhje me përpunimin e të dhënave personale nga organet kompetente për qëllime të parandalimit, hetimit, zbulimit, ndjekjes së veprave penale ose ekzekutimit të dënimeve penale, si dhe me lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave*”, është ndër parashikimet e vendosura nga ana e Zyrës së Komisionerit në tabelen e planifikimit të akteve që përafrojnë *acquis*, me qëllim realizimin e Planit Kombëtar të Integritetit Evropian 2018 – 2020 (PKIE). Në zbatim të përmbushjes dhe realizimit të PKIE 2018-2020, është parashikuar miratimi i ligjit të ri “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe transpozimi i rregullores së GDPR-së dhe Direktivës së Policisë në tre mujorin e tretë të vitit 2020.

Komisioneri është përfitues i asistencës së programit IPA II 2017 sipas aktivitetit “*Ndërtimi i institucioneve për harmonizimin me *acquis* të BE-së për të përmbushur kriteret ekonomike lidhur me mbrojtjen e të dhënave*”. Në këto kushte, Zyra e Komisionerit do të nisë procesin e përafrimit të legjislacionit tonë, më konkretisht të ligjit nr.9887/2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, të ndryshuar, si edhe akteve nënligjore, me Rregulloren 2016/679 të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së (GDPR) dhe Direktivën 2016/680, për të cilën nevojitet atashimi i një misioni ekspertësh të BE-së pranë Zyrës së Komisionerit, me qëllim:

- Analizimin dhe krahasimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor shqiptar në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
- Dhënie ekspertize stafit të Zyrës së Komisionerit mbi risitë e Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së (GDPR);
- Asistencë në hartimin e legjislacionit të ri shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave të BE-së;
- Asistencë në hartimin e kuadrit nënligjor të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, i ndryshuar, etj.

Aktualisht, në kuadër të përgatitjeve për implementimin e projektit IPA II 2017, Zyra e Komisionerit ka ngritur Njësine Përgjegjëse.

13.2 Miratimi i ndryshimeve të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Gjatë zbatimit të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, janë evidentuar disa raste për të cilat legjislacioni aktual nuk ofron zgjidhje. Në këtë drejtim, Zyra e Komisionerit edhe në dokumentin e Strategjisë 2017-2020 ka argumentuar se rishikimi i këtij ligji është i nevojshëm. Gjatë vitit 2018, janë përgatitur amendimet përkatëse. Për këto amendime ka ofruar këshillim edhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri.

Qëllimi i projektligjit është të garantojë më mirë mundësinë dhe aksesin e publikut në informacion nëpërmjet hapjes dhe transparencës, një nevojë e identifikuar nga Zyra e Komisionerit. Në këtë drejtim, Zyra e Komisionerit (pas konsultimit edhe me ekspert ndërkombëtar apo aktor të shoqërisë civile) i ka pasqyruar amendimet me qëllim përmirësimin e ligjit, si më poshtë vijon:

- nevojën për të pasur vendimet e Komisionerit titull ekzekutiv si dhe parashikimin e sanksioneve për autoritetet publike në rast moszbatimi të vendimit të Komisionerit;
- qartësimin e detyrimit të drejtuesit të autoritetit publik për emërimin e koordinatorit për të informimit dhe përcaktimin e pozicionit të tij në hierarkinë e autoritetit publik;
- vendosjen e sanksioneve jo vetëm ndaj koordinatorit apo nëpunësve të autoritetit publik, por edhe personit përgjegjës për mosdhënie të informacionit;
- të drejtën e Komisionerit për t’u përfshirë në procesin e deklasifikimit të informacionit “Sekret Shtetëror”;
- kufizimin e zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit vetëm për informacionin që ka të bëjë me veprimtarinë administrative të organeve të sistemit gjyqësor apo të prokurorisë;
- krijimin e një Bordi Këshillimor, etj.

Projektakti, gjatë vitit 2018 iu nënshtrua procesit të konsultimit publik me grupet e interesit në një sërë forumesh. Më 12.06.2018 Komisioneri për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbajti “Konferencën e IV Kombëtare “Për të drejtën e informimit – Për një ligj edhe më të mirë””, në të cilën u prezantua projeakti dhe u diskutuan dhe u morën opinionet përkatëse. Diskutime në këtë drejtim janë mbajtur edhe në tre forume me shoqërinë civile, realizuar në kuadër të “Projektit të Binjakëzimit Antikorrupsion Shqipëri-BE”, me koordinimin e Zyrës së Komisionerit.

13.3 Ndryshime në ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin e konsultimit publik”

Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik erdhi si pjesë e paketës së propozuar nga shoqëria civile, për të përmbushur nevojën për një qeverisje më transparente me pjesëmarrjen e publikut në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse nga organet publike. Ligji për njoftimin dhe konsultimin publik është miratuar në datën 30.10.2014 dhe ka hyrë në fuqi në maj të vitit 2015.

Meqenëse ligji për njoftimin e konsultimit publik dhe e drejta e informimit lidhen dhe kanë qëllime të përbashkëta, mund të vlerësohet që monitorimi edhe i këtij ligji të kryhet nga një institucion i pavarur.

Bazuar në parashkimet e pikës 3 dhe 4 të nenit 21, të ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin e konsultimit publik”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrton kërkesën dhe arrin në përfundimin që ka shkelje, i propozon organit publik marrjen e masave ndaj personit përgjegjës. Për ta bërë sa më efektiv zbatimin e këtij ligji, sugjerojmë se duhet të parashikohet e drejta e Komisionerit për të marrë vendime në përputhje me shkeljet e konstatuara.

13.4 Miratimi i projekt/ligjit “Mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik” dhe përafrimi me direktivën 2013/37/EU

Zyra e Komisionerit vlerëson të rëndësishme miratimin e këtij projekt ligji me synim përafrimin e legjislacionit shqiptar me atë komunitar dhe konkretisht Direktivën 2013/37/EU “Për ri-përdorin e informacionit të sektorit publik”.

Rezultat i kësaj iniciative është edhe evidentimi dhe përmbushja e pjesës së munguar të legjislacionit në fuqi, duke mundësuar ripërdorimin e dokumenteve të bëra publike më shumë se një herë nga ana e organeve të sektorit publik.

Projektligji “Mbi ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, ka për qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit si dhe lehtësimin e aksesit në një dokumentacion të kërkuar për t’u bërë i aksesueshëm më shumë se një herë. Në këtë mënyrë, shtohet një tjetër ligj që garanton transparencën dhe llogaridhënien, duke rritur më tepër besimin e çdo individi i cili kërkon të pajiset me të njëjtin dokumentacion, për një qëllim të ndryshëm nga i pari, nga ana e organeve të sektorit publik.

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ofrimi i praktikave më të mira me qëllim eliminimin e vonesave që kanë të bëjnë më përshtatjen, apo veçimet e një pjese të informacionit si dhe reduktimin e shpenzimeve shtesë, në ripërdorimin e dokumentacionit që mbahet nga organet e sektorit publik.

13.5 Modernizimi i Konventës për Mbrojtjen e Individëve nga Përpunimi Automatik i të Dhënave Personale e Këshillit të Evropës (Konventës 108 +)

Për shkak të sfidave të reja të mbrojtjes së të dhënave personale në epokën digjitale si edhe duke qenë se dispozitat e Konventës 108 “Për mbrojtjen e individëve nga përpunimi automatik i të dhënave personale” shfaqnin nevojën e përshtatjes me kontekstin aktual, Komiteti Konsultativ (T-PD) i Konventës 108 dhe Komiteti *ad hoc* CAHDATA, pas një punë 7-vjeçare, konkretizuan propozimet për modernizimin e Konventës.

Procedurat e nënshkrimit për këtë protokoll u hapën fillimisht për nënshkrim më datë 25 qershor 2018, në Strasburg, por më pas u vendos që hapja të bëhet më datë 10 tetor 2018. Konventa 108 ka shërbyer si baza e legjislacionit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes së të dhënave si i vetmi instrument ligjor detyrues në nivel ndërkombëtar.

Republika e Shqipërisë e ka nënshkruar Konventën 108 më datë 09.06.2004 dhe e ka ratifikuar me anë të ligjit nr.9288, datë 07.10.2004 “Për ratifikimin e Konventës 108 “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale”, i ndryshuar me ligjin nr.9, datë 02.02.2017. Gjithashtu me anë të ligjit nr.9287, datë 07.10.2004 ka ratifikuar Protokollin Shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave”.

Zyra e Komisionerit në përputhje me nenin 13 të Konventës, është autoriteti i përcaktuar për bashkëpunimin midis palëve. Gjithashtu, ajo merr pjesë si anëtare me të drejtë vote në Komitetin Konsultativ të Konventës 108 (Komiteti T-PD) që prej vitit 2009, duke kontribuar gjithashtu edhe në Komitetin *ad hoc* CAHDATA të KiE-së të ngarkuar për modernizimin e kësaj konvente.

Nga komunikimi me Sekretariatën e Komitetit Konsultativ (T-PD) të Konventës 108, jemi njoftuar se aktualisht kanë konfirmuar nënshkrim në datën 10 tetor 2018 mbi 15 shtete Palë të Konventës. Ndërsa Komiteti i Ministrave ka theksuar si tepër të rëndësishme që të bëhet anëtarësim sa më i shpejtë në Protokoll nga një numër sa më i madh shtetesh, me qëllim që të lehtësohet krijimi i një regjimi juridik global i mbrojtjes së të dhënave në përputhje me Konventën e modernizuar.

Për sa më sipër, mbetet për të vijuar dhe intensifikuar procedurat nga institucionet shqiptare për nënshkrimin e Protokollit të ndryshimit të Konventës 108 të datës 10 tetor 2018.

13.6 Aderimi në Konventën 2009/205 të Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”

Zyra e Komisionerit e ka vlerësuar shumë të rëndësishme **Konventën nr.2009/205 të Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare”**, duke qenë se Konventa synon garantimin efektiv të së drejtës për akses në dokumentet zyrtare.

Në këtë kuadër, ka pasur një korrespondencë midis Zyrës së Komisionerit, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme me qëllim nisjen e procedurave ligjore për aderimin e Republikës së Shqipërisë në këtë Konventë.

Zyra e Komisionerit, ka kontribuar në hartimin e projektligjit dhe relacionit të tij duke e vlerësuar të rëndësishëm aderimin në Konventën nr.205/2009 të Këshillit të Evropës “Mbi aksesin në dokumentet zyrtare” pasi do të plotësonte dhe zhvillonte më tej kuadrin ligjor në fuqi për të drejtën e informimit.

14. VIZIONI I INSTITUCIONIT

Vizioni i Zyrës së Komisionerit, është garantimi i zbatimit të rregullave të legjislacionit për të drejtën e informimit dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale. Në këto kushte, prioritet mbetet forcimi i llogaridhënies së autoriteteve publike dhe kontrolluesve publik e privat, forcimi i transparencës, duke garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Gjithashtu, zhvillimet në luftën kundër korrupsionit do të vijojnë të mbështeten nga Zyra e Komisionerit. Ky angazhim do të përbëjë një tjetër sfidë për institucionin, në rritjen e përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike, për sigurimin e një administrate publike që ofron shërbime me cilësi për qytetarët, institucione transparente dhe nëpunës publik me integritet të lartë.

Si autoritet i pavarur në monitorimin dhe mbikëqyrjen e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, Zyra e Komisionerit, do vijoj të synoj konsolidimin dhe të forcojë rolin e saj të pavarur mbikëqyrës në të dy këto shtylla të rëndësishme.

Bashkëpunimi dhe partneriteti i mirë midis organeve publike dhe publikut në garantimin e transparencës dhe pjesëmarrjen e të gjitha palëve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse do të jetë vizioni i të gjithëve për të arritur avancimin e vendit tonë në rrugën e tij drejt integritetit Evropian.

Objektivat kryesorë për një zbatim të suksesshëm të ligjit për të drejtën e informimit do të jenë:

- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut;
- Bashkëpunim me shoqërinë civile si partner në garantimin e të drejtës për informim;
- Konsolidimi i kuadrit ligjor;
- Përmirësimi, trajnimi dhe monitorimi i vazhdueshëm i autoriteteve publike;
- Monitorim lidhur me emërimin/ndryshimin e koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe trajnimi i vazhdueshëm i tyre;
- Monitorim i përditësimit të programeve të transparencës dhe regjistrat të kërkesave dhe përgjigjeve;
- Rritja e numrit të hetimeve administrative;
- Krijimi i një jurisprudence cilësore.

Krijimi i një kulture gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave personale në ambientet digjitale është një nga sfidat që Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të ballafaqohet në vitet në vijim.

Shqipëria si një vend që aspiro për të qenë anëtare e Bashkimit Evropian duhet të përshtasë legjislacionin e saj të brendshëm me atë të *acquis* të BE-së dhe një ndër qëllimet kryesore të Zyrës së Komisionerit, për zbatimin e objektivave të parashikuara në fushën

për mbrojtjen e të dhënave personale, është harmonizimi i legjislacionit aktual me Rregulloren e Përgjithshme të Bashkimit Evropian GDPR-së.

Hyrja në fuqi e GDPR-së, në maj të vitit 2018, ka sjellë angazhimin maksimal të Zyrës së Komisionerit lidhur me harmonizimin me legjislacionin e brendshëm.

Vizioni i Zyrës së Komisionerit dhe disa nga objektivat për periudhën 3-vjeçare të zbatimit të strategjisë në kuadër të hyrjes në fuqi të “Rregullores të Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave” (GDPR) janë:

- Përafrimi i legjislacionit shqiptar për mbrojtjen e të dhënave personale me Rregulloren e BE-së 679/2016, dhe Direktiva 680/2016;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit të Zyrës së Komisionerit në kuadër të harmonizimit të ligjit me *acquis communautaire*;
- Bashkëpunimi dhe partneriteti me homologët e shteteve anëtare të BE-së dhe institucionet shtetërore;
- Mbrojtja e të dhënave personale në sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
- Njohja dhe ndërgjegjësimi i kontrolluesve publikë dhe atyre privatë mbi rrisitë e ligjit të ri të harmonizuar;
- Edukimi i studentëve për të drejtat dhe përgjegjësitë e përdorimit të të dhënave personale në sistemin digjital.

Mbetet mision kryesor i Zyrës së Komisionerit ndërgjegjësimi i gjithë shoqërisë shqiptare me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale. Ndërgjegjësimi në këto raste nis në radhë të parë me edukimin e fëmijëve në moshën shkollore për mbrojtjen e privatësisë, edukimin e studentëve dhe specialistëve me parimet e *privacy by design* dhe *privacy by default*.

Një tjetër sfidë kyesore e Zyrës së Komisionerit për këtë vit është edhe organizimi i Konferencës Botërore të Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave, në Shqipëri. Si vend i shpallur fitues nga ana e Komitetit Ekzekutiv të Konferencës, Shqipëria ka për të organizuar eventin më të rëndësishëm të autoriteteve dhe të ekspertëve të mbrojtjes së të dhënave personale.

Konferenca Botërore e Komisionerëve të Mbrojtjes së të Dhënave dhe Privatësisë “Tirana 2019” do të zhvillohet në periudhën 21-24 tetor 2019. Është hera e parë që një Konferencë botërore, e përmasave të tilla organizohet në Ballkanin Perëndimor.

Zhvillimi i saj në Tiranë është vlerësim edhe për përpjekjet e vendeve të rajonit tonë në ndërtimin e shoqërive demokratike dhe respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut.

Për sa më lart Zyra e Komisionerit do të synojë të zhvillojë më tej vizionin e saj, të rrisë dhe të garantojë në nivelet e kërkuara zbatimin e dy të drejtave kushtetuese, të japë zgjidhje praktike në kohë reale si dhe të ndëshkojë shkeljet e ligjit.

ANEKS 1

Në referencë të kapitullit 4 “Veprimtaria ligjore, procedurat administrative dhe gjyqësore”, të raportit vjetor, gjatë vitit 2018 Zyra e Komisionerit ka dhënë mendim për projekt aktet si më poshtë:

Projektligjin “Për vlerësimin kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projektligjin “Për Censin e Popullsisë dhe Banesave”, dërguar nga Instituti i Statistikave dhe nga Kryeministria;

Projektligjin “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

Projektvendimin për miratimin në parim “Të marrëveshjes bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për personat e humbur (ICMP)”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projektvendimin “Për miratimin e rregullores “Për disenjot industriale”, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

Projektvendimin “Për miratimin e në parim të marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Eurojust-it dhe Republikës së Shqipërisë”, dërguar nga Ministria e Drejtësisë;

Projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1707 datë 29.12.2008 “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, të ndryshuar, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

Projektvendimin “Për përcaktimin e tarifave dhe pagesave për shërbimet ndaj institucioneve apo personave, që ofrohen nga AIDSSH”, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

Projektvendimin “Për miratimin në parim të marrëveshjes ndërmjet palëve të konventës të bashkëpunimit policor për Evropën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projektvendimin për miratimin në parim të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Humbur (ICMP)”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projektvendimin “Mendim mbi projektvendimin “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1707 datë 29.12.2008 “Për miratimin e rregullores për lëshimin e patentave për shpikjet dhe modelet e përdorimit”, të ndryshuar”, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

Projektvendimin “Për llojet, mënyrën e shkëmbimit dhe e përpunimit të informacionit të të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen

e Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”, dërguar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

Projektvendimin “Për miratimin e Strategjisë së Drejtësisë për të Miturit dhe Planin e Veprimit të saj” dërguar nga Ministria e Drejtësisë;

Memorandum Mirëkuptimi “Ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Memorandum Mirëkuptimi “Operacional kundër drogrës ndërmjet drejtorisë së përgjithshme të Policisë së Shtetit të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë Qendrore për shërbimet e Antidrogës në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Italisë”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Memorandum Mirëkuptimi “Memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Kroacisë mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë së kufijve”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projekt/Marrëveshjen “Për riparimin dhe protokollet e zbatimit me Marokun, Afganistanin, Irakun dhe Iranin”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projekt/Marrëveshjen “Zbatuese mbi Mbrojtjen e të Dhënave për Konventën e Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projekt/Marrëveshjen “Në fushën e mbrojtjes shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zviceriane”, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;

Projekt/Marrëveshjen “Për bashkëpunim në fushën e sigurisë së kufirit”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projekt/Marrëveshjen “Mbi krijimin e bashkëpunimit operacional ndërmjet Agjencisë Europiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional në Kufijtë e Jashtëm, të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian (FRONTEX) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Shqipërisë”, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projekt/Marrëveshjen “Për njohjen reciproke të patentë shoferëve”, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, dërguar nga Ministria e Brendshme;

Projekt-udhëzim “Për përcaktimin e numrit të faqeve për të cilat informacioni përfitohet falas, rastet e përjashtimit nga pagesa e tarifës, si dhe rregulla për mënyrën e kryerjes së pagesës për pajisjen me informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritet publike”, dërguar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Janë dhënë opinione ligjore për dokumente të rëndësishëm, ardhur nga institucione të ndryshme disa prej të cilave:

- Opinion lidhur me *“Marrjen e pëlqimit të subjekteve të të dhënave gjatë aplikimit online për kredi në institucionet bankare”*, drejtuar Bankës së Shqipërisë.
- Opinion për ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 *“Për Arkivat”* dhe *“Propozimit për planin e punës të grupit ndërinstitucional dhe tematikat që duhet të shqyrtohen”*, dërguar Grupit Ndërinstitucional për Arkivat.
- Opinion për mbi subjektin kontrollues *“Vodafone Albania”* sh.a në lidhje me informacionin e kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.
- Opinion mbi njoftimin për transferimin e të dhënave personale drejt Mbretërisë së Bashkuar për qëllime studimore dhe shkencore, drejtuar Universitetit të Bedfordshire
- Opinion mbi paketën e projekteve nënligjore të hartuara në zbatim të *“Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur”*, dërguar nga Ministria e Drejtësisë.
- Opinion për kërkesën e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat *“Për mbajtjen e qëndrimit zyrtar të Ministrisë së Drejtësisë mbi parimin e konfidencialitetit në veprimtarinë e shërbimit përmbarimor dhe respektimit të kriterëve ligjore që lidhen me standardet kontrolluese dhe mbikëqyrjes së profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat”*, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.
- Opinion për *“Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit
- Opinion për përpunimin/transferimin e të dhënave personale të një subjekti të dhënash drejt një përfaqësie diplomatike, drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Opinion për projekt rregulloren *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Opinion lidhur me kërkesën për opinion ligjor të paraqitur nga Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.
- Opinion për projektvendim e Këshillit të Ministrave *“Për llojet mënyrën e shkëmbimit dhe përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat e Mbrojtjes së Fëmijës, pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”*, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Opinion për projekt udhëzimin për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzim nr.12, datë 27.4.2015, *“Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbajtjen e dosjeve të tyre personale”*, drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.
- Opinion lidhur me kërkesën e Zyrës Ndërlidhëse të Emigracionit në Ambasadën Britanike për përdorimin e të dhënave të mbledhura mbi bazën e *“Memorandumit të Mirëkuptimit për Shkëmbimin e të Dhënave”* nga ana e një Gjykate Britanike, drejtuar Policisë së Shtetit.
- Opinion për dhënien e pëlqimit paraprak online nga klientët për kërkim në Regjistrin e Kredive të Bankës së Shqipërisë.
- Opinion për zbatimin e detyrimeve në kuadër të Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

ANEKSI 2

Në referencë të kapitullit 4 “Veprimtaria ligjore, procedurat administrative dhe gjyqësore” të raportit vjetor, aktet ligjore dhe nënligjore të miratuara, të cilat duhet të kishin marrë më parë mendimin e Zyrës së Komisionerit.

Ligje të cilat nuk janë paraqitur për mendim:

1. Ligji nr.14, datë 29.03.2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë për mbrojtjen shoqërore”, (fz nr.51/2018);
2. Ligji nr.19, datë 05.04.2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Francës dhe Komisionit Evropian për Programin Interreg V-B Mesdhe (MED), 2014–2020”, (fz nr.62/2018);
3. Ligji nr.20, datë 12.4.2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet këshillit të ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për vërtetimin e periudhave të sigurimit për realizimin e së drejtës për pension”, (fz nr.62/2018);
4. Ligji nr.21, datë 12.4.2018, “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Italisë dhe Komisionit Evropian për Programin Interreg V-B Adriatiko-Jonian (ADRION) 2014-2020”, (fz nr.63/2018);
5. Ligji nr.42, datë 09.07.2018, “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”, (fz nr.111/2018).

VKM të cilat nuk janë paraqitur për mendim:

1. Vendimi nr. 101, datë 23.02.2018 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit” (fz nr. 27/2018);
2. Vendimi nr. 134 datë 07.03.2018 “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore për sistemin e integruar bibliotekar DataBKSH” (fz nr. 34/2018);
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 273, datë 16.05.2018, “Për krijimin e regjistrit qendror të bazës së të dhënave për llogaritjen e taksës vendore të pasurisë së paluajtshme “ndërtesë” (kadastra fiskale)” (fz nr. 74/2018);
4. Vendimi nr. 214, datë 11.10.2018, “Mbi miratimin e kodit të rrjetit mbi rregullat e ndërveprimit dhe të shkëmbimit të të dhënave” (fz nr. 153/2018);
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 26.10.2018, “Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike” (fz nr. 155/2018).

Udhëzime të cilat nuk janë paraqitur për mendim:

1. Udhëzimi nr. 7 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë datë.19.02.2018 “Për miratimin e elementeve dhe formës së kontratës së shërbimit ndërmjet institucionit të arsimit të lartë jopublik dhe studentit” (fz nr. 28/2018).